



USHTRIA



Viti i 77-të i botimit Nr. 8 (827863)

Botim Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

E premte, 23 shkurt 2024

Ministri i Mbrojtjes Peleshi: Do të punojmë me besnikëri për fqinjësinë e mirë, stabilitetin politik dhe sigurinë në rajon



Ministri Peleshi: Shqipëria, në mbështetje të nismave rajonale dhe vlerave demokratike

Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi dhe shefi i Shtabit të Përgjithshëm, gjeneralmajor Arben Kingji pritën në një takim komandantin e Brigadës së Evropës Juglindore (SEEBRIG), gjeneral brigade Bilbil Bitri dhe stafin që e shoqëronte.

Ministri Peleshi i shprehu edhe një herë urrejtjen gjeneral Bitrit për marrjen e detyrës së Komandantit të SEEBRIG, si dhe ritheksoi dhe njëherë qëndrimin e Ministrisë së Mbrojtjes në mbështetje të plotë të çdo iniciative rajonale, e cila promovon fqinjësinë e mirë, vlerat demokratike, angazhimin e përbashkët për paqen dhe sigurinë në rajon dhe më tej.

Ministri Peleshi e siguroi komandantin e SEEBRIG për mbështetjen që Shqipëria i jep Iniciativës së SEDM dhe Brigadës së SEEBRIG; rezultat i kësaj mbështetjeje është përmbushja e të gjitha detyrimeve dhe plotësimi i kriterëve të vendit tonë kundrejt këtyre angazhimeve rajonale.

Ndërsa nga ana e tij shefi i Shtabit të Përgjithshëm, gjeneralmajor Arben Kingji u shpreh se: “SEEBRIG është një njësi e rëndësishme rajonale në kontributet që jep për paqen dhe bashkëpunimin rajonal, nga ku do të angazhohemi për gjetjen e



hapësirave të reja të bashkëpunimit, krijimin e një mjedisi pozitiv multikulturor, si dhe do vijojë kontributi në mbështetje të operacioneve në mbështetje

të paqes dhe krizave humanitare”.

Gjeneral brigade Bilbil Bitri falënderoi ministrin e Mbrojtjes dhe shefin e Shtabit të Përgjith-



shëm, gjeneralmajor Arben Kingji për kontributin dhe mbështetjen e vazhdueshme të Shqipërisë ndaj iniciativës së SEDM dhe SEEBRIG.



Forcat Detare realizuan trajnim me Distriktin Detar Verior dhe Qendrën Stërvitore Detare

Në Portin Detar Durrës, në kalatën 0, ku janë të dislokuara anijet e Distriktit Detar Verior të Forcës Detare/Rojës Bregdetare, u zhvillua ceremonia e trajnimit treditor “Lufta Kundra Zjarrit në Anije”, me personelin e Forcës së Sigurisë Portuale dhe Policinë e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi.

Në ceremoni mori pjesë komandanti i Distriktit Detar Verior, kapiten i rangut II Dritan Seraj, i cili, pasi i falënderoi të pranishmit në ceremoni, u uroi suksese në trajnimin e organizuar nga efektivë të Distriktit Detar Verior dhe Qendrës Stërvitore Detare, Pashaliman.

Qëllimi i këtij trajnimi është përgatitja dhe aftësimi i personelit në veprimet praktike që duhet të bëhen, analizimin, menaxhimin dhe marrjen e vendimeve për organizimin për fikjen e zjarrit. Personeli merr bazën e njohurive për detyrat bazë që ka si individ dhe ajo që është më e rëndësishme organizimi i veprimeve si grup i ndërhyrjes për fikjen e zjarrit.

Gjatë trajnimit treditor do të zhvillohen tema teorike

dhe praktike që përfshijnë aspektet e përgjithshme të luftës kundra zjarrit në anije, llojet e zjarrit, agjentët fikës të zjarrit, metodat dhe mënyrat e fikjes së zjarrit.



Operacion SAR nga efektivët e anijes P - 133 “Lissus”

Anija P - 133 “Lissus” pjesë e misionit Sea Guardian në detin Egje, gjatë lundrimit në zonën e patrullimit, mori njoftim nga Roja Bregdetare greke për një gomone të nisur nga brigjet e Turqisë drejt brigjeve greke. Në gomone ndodheshin 25 emigrantë, në mes tyre 3 gra dhe 22 burra.

Emigrantët ishin nga Jemeni, Sudani dhe Palestina. Roja Bregdetare turke ka marrë në bord personat që ndodheshin në gomone për të ndjekur procedurat e mëtejshme.





Ministri Peleshi: Do të punojmë me besnikëri për fqinjësinë e mirë, stabilitetin politik dhe sigurinë në rajon

Në kuadër të takimit të Këshillit Strategjik të Nivelit të Lartë, kryeministri Edi Rama, i shoqëruar nga kabineti qeveritar, vizitoi Turqinë, ku u prit në një ceremoni zyrtare nga Presidenti i Republikës së Turqisë, Recep Tayyip Erdoğan. Delegacioni shqiptar, pjesë e të cilit ishte dhe Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi u mikprit me nderime të larta. Pas ceremonisë së rastit në Presidencën e Republikës së Turqisë, Kryeministri Rama dhe Presidenti turk Erdogan zhvilluan një takim bilateral mes tyre.

Më pas, Kryeministri Rama dhe Presidenti Erdogan drejtuan mbledhjen e bashkëpunimit të nivelit të lartë midis dy vendeve, me pjesëmarrjen edhe të disa prej ministrave të kabineteve qeveritare respektive. Në kuadër të forcimit të mëtejshëm të bashkëpunimit mes Turqisë dhe Shqipërisë u nënshkruan disa marrëveshje dhe memorandumë mirëkuptimi dypalëshe në fushën e mjedisit, mbrojtjes, të medias dhe komunikimit.

Mes Ministrisë së Mbrojtjes së Shqipërisë dhe asaj të Turqisë u nënshkrua edhe Marrëveshja Kuadër ushtarake ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Turqisë.

Në Takimin e Bashkëpunimit të Nivelit të Lartë që u mbajt mes dy vendeve, ministri Peleshi vlerësoi se kjo marrëveshje është shprehje e bashkëpunimit edhe për shumë vite në vazhdim. Ministri Peleshi falënderoi qeverinë turke për mbështetjen e vazhdueshme në modernizimin e Forcave të Armatosura shqiptare me pajisje të rëndësishme si dronët “Bayraktar”, mjete ushtarake si dhe për trajnimin e personelit tonë ushtarak. Më tej, ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi ftoi autoritetet turke të marrin pjesë në ceremoninë e inaugurimit të Bazës Ajrore të Kuçovës, më 4 mars.

Teksa shprehu synimin e FA-së shqiptare për të shtuar prezencën në misionet jashtë vendit, ministri Peleshi tha se trupat shqiptare do të jenë nën komandën e atyre turke në misionin ALTHEA në Bosnjë - Hercegovinë.

Ministri i Mbrojtjes theksoi se Shqipëria do të punojë në mënyrë konstruktive dhe me besnikëri për të promovuar fqinjësinë e mirë, stabilitetin politik, sigurinë dhe zhvillimin ekonomik të qëndrueshëm në rajon.





Gjeneralmajor Arben Kingji inspektoi stërvitjen "Reagim i Menjëhershëm - 24"

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH-së, gjeneralmajor Arben Kingji inspektoi stërvitjen "Reagim i Menjëhershëm - 24", e cila u zhvillua nga kursantët e Kursit të Lartë të Oficerit në kuadër të programit mësimor.

Gjeneralmajor Arben Kingji, pasi ndoqi nga afër prezantimin mbi "Analizën e Misionit", ku kursantët të vendosur në rolet respektive prezantuan mbi skenarin e dhënë, adresoi një falënderim për stafin drejtues dhe atë pedagogjik, për masat e marra, për drejtimin dhe zhvillimin me sukses të kësaj stërvitjeje. "Kolegji i Mbrojtjes dhe i Sigurisë, si institucion i ri në Forcat e Armatosura, është në rrugën e duhur për rritjen e cilësisë së edukimit dhe arsimimit të ushtarakëve dhe civilëve të Forcave të Armatosura, Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe më gjerë, dhe stërvitjet janë element i rëndësishëm i punës sonë, ndaj Kolegji duhet të vijojë me plotësimin e kurrikulës dhe të programeve mësimore me të dhënat më të fundit të zhvillimeve në NATO e më gjerë...", - u shpreh ndër të tjera SHSHPFA, gjeneralmajor Arben Kingji.

Kjo stërvitje iu shërben kursantëve për përvetësimin e aftësive mbi zbatimin e koncepteve doktrinale për përdorimin e forcave ushtarake në operacione luftarake si dhe planëzimin, koordinimin dhe bashkëveprimin me aktorët civil brenda zonës së operacionit.



Baza e Mbështetjes së Emergjencave Civile, në ndihmë të komunitetit civil

Për shkak të situatës kritike të krijuar nga rritja e nivelit të ujit në liqenin artificial të Tiranës, i cili përbente rrezik për digën e liqenit, me kërkesën për bashkëpunim dhe mbështetje të Ndërmarrjes së Ujësjetës Kanalizimeve, Tiranë, Baza e Mbështetjes së Emergjencave Civile (BMEC), angazhoi forcat, mjetet dhe agregatat në operacion për uljen e nivelit të ujit në Liqenin Artificial të Tiranës.

BMEC edhe njëherë ka treguar gatishmërinë për t'i ardhur në ndihmë komunitetit civil, duke bërë të mundur normalizimin e nivelit të ujit në liqenin artificial të Tiranës.



Përfundoi me sukses operacioni EOD në qytetin e Durrësit

Një ekip prej tre specialistesh EOD të Batalionit të Xhenios asistoi në verifikimin, asgjësimin dhe transportimin e një predhe topi 100 mm italiane të Luftës së Dytë Botërore të gjetur në bashkinë Durrës.

Nga ekipi EOD u morën masat e nevojshme për sigurimin e municionit të paplasur dhe zonës përreth, konform manualit dhe rregullave EOD.

Mbas verifikimit dhe vlerësimit të bërë nga ekipi EOD rezultoi se municioni i paplasur ishte i rrezikshëm, por i lëvizshëm, ku dhe u transportua dhe magazinua në Batalionin e Xhenios, duke zbatuar të gjitha rregullat e sigurisë.



Komanda Mbështetëse vazhdon të japë kontributin e saj në ndërtimin e urave "Bailey"

Specialistët e Kompanisë së Urave të Batalionit të Xhenios, në Komandën Mbështetëse, kanë përfunduar montimin e urës tip "Bailey", 15 m të gjatë me seksion 2/1, në fshatin Stojan, bashkia Mat. Ndërtimi i kësaj ure, e cila ndodhet pranë një monumenti kulti siç është Kisha e Shna Ndojt, i shërben jo vetëm 400 banorëve të zonës për lidhjen me qendrën shëndetësore, shkollën dhe rrugën nacionale, por një komuniteti më të gjerë të cilët vijnë çdo të diel për kryerjen e riteve fetare të pelegrinazhit në këtë kishë. Për inaugurimin e përfundimit të punimeve, ishte i pranishëm zëvendëskomandanti i Komandës Mbështetëse, kolonel Shkëlqim Çela dhe përfaqësues të bashkisë Mat, të cilët falënderuan specialistët xhenierë për kontributin e çmuar në ndihmë të komunitetit.





*Shqipet mbjellin paqe në çdo prag
Ata i kthejnë buzëqeshjen çdo fëmije
Feti Vogli mbjell lule Shqipërie
Skënderbegas të rriti ushtria
Ku rrojnë bashkë nderi dhe lavdia
O pishtar me dritë lirie
Feti Vogli prej Shqipërie*

Ushtarakët shqiptarë kujtojnë ndarjen nga jeta në krye të detyrës të Kapiten Feti Voglit. Ai u nda nga jeta gjatë një misioni ushtarak, më 20 shkurt të vitit 2012, pas një misioni të marrë nga komanda amerikane për të shoqëruar një zyrtar të SHBA-së në një shkollë dhe në një spital të Afganistanit. Por u sulmuan nga një taleban, i cili hapi zjarr me mitraloz në drejtim të Feti Voglit që nuk i mbijetoi plagëve. Në këtë sulm, ku mbeti i vdekur Kapiten Feti Vogli, nga të shtënat u plagos rëndë dhe ushtari Aleksandër Peçi. Kapiten Feti Vogli, lindi më 23.05.1981, në fshatin Baldushk të rrethit të Tiranës. Pas mbarimit të Akademisë Ushtarake në specialitetin Artileri Tokësore, u bë pjesë e Forcave të Armatosura, me detyrë komandant Toge në Brigadën e Stërvitjes të Bazës, Bunavi. Pas kryerjes me sukses të kursit Bazë të Forcave Speciale, më 16 korrik 2005, u bë pjesë e Batalionit të Forcave Speciale me detyrë Komandant Grupi. Nga data 1 qershor 2010 kryente detyrën e komandantit të Grupit të Parë Special në kompaninë e Aksioneve Speciale Ujore. Kapiten Feti Vogli ishte një ushtarak karriere i shkëlqyer dhe si rezultat i arritjeve në detyrë është dekoruar disa herë me medalje të ndryshme si: Medalja e Karrierës në vitin 2007, nga komandanti i Forcës së Bashkuar; Medalja për Shërbime Ndërkombëtare nga ministri i Mbrojtjes në vitin 2007 dhe Medalje për shërbime të Shquara nga ministri i Mbrojtjes në vitin 2010. Misioni “Eagle 4” i Forcave Speciale që la gjurmë të thella, kujtohet me krenari nga pjesëtarët e Forcave Speciale, por edhe nga përfaqësues të lartë të shtetit dhe ushtarakë të lartë Amerikanë. Figura e kapiten



Feti Voglit kujtohet dhe nderohet jo vetëm nga personeli i Forcave Speciale, por nga të gjithë strukturat e MM-së dhe SHP-së. Veprat sublime të njerëzve që bien për idealet e larta të lirisë nuk mund të harrohen, ato kujtohen me respekt dhe përlujë. Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi në ditën

e rënies së dëshmorit Feti Vogli do të shprehte vlerësimin dhe respektin e pakufi për njerëz të cilët kanë ngritur lart emrin e Shqipërisë deri në dhënien e jetës, në emër të jetës: “Lavdi përjetë dëshmorit të atdheut kapiten Feti Vogli! I përjetshëm në memorien e Forcave të Armatosura”. Ndërsa shef

i Shtabit të Përgjithshëm, gjeneralmajor Arben Kingji do shprehej “E paharruar do mbetet vepra e Dëshmorit të Atdheut kapiten Feti Vogli, i rënë në krye të detyrës 12 vite më parë, në Afganistan. Lavdi dhe mirënjohje të përjetshme për sakrificën sublime për të gjithë Dëshmorët e Atdheut”.



ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

17 Shkurti i vitit 2008 shënon një nga datat më të rëndësishme të historisë së Kosovës dhe përmbyll sakrificën e popullit kosovar për liri e pavarësi.

Kjo datë rrjedh si kontribut i gjeneratave të tëra, të cilat kërkesë të vetme kishin pavarësinë e Kosovës dhe çlirimin e saj prej Serbisë.

Nuk duhen harruar eshtrat e pleqve, grave, të rinjve dhe fëmijëve të zhdukur të Mejës, Krushës, Lybeniqit, Gjakovës, Pejës, Mitrovicës, Fushë Kosovës, Klinës, Dubravës, e mijëra të zhdukurve të tjerë, ku fati i mbi 1600 personave akoma nuk dihet. Nuk duhen harruar gjymtyrët, plagët dhe kontributi i qindra ushtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, pa të cilën kjo luftë nuk do të kishte liri dhe pavarësi.

Nuk duhen harruar vuajtjet e dënimeve në burgjet jugosllave të patriotëve shqiptarë, të rinisë së Kosovës dhe lëvizjeve të brezit të 1968, 1981 dhe 1997, të cilët rezistonin me ide të flakta për flamur, pavarësi dhe liri.

Nuk duhet harruar rezistenca paqësore e viteve ‘90 dhe aktiviteti i lëvizjeve politike shqiptare në Kosovë.

Nuk duhet harruar roli dhe kontributi i mësuesve, sidomos gjatë viteve të ‘90, të cilët nën masa të dhunshme mbanin gjallë pa asnjë qindarkë mësimin shqip në shtëpi shkolla, duke edukuar gjenerata të tëra në kushte mizore.

Me këmbënguljen e politikës amerikane, ndryshimi i statusit të Kosovës u ideua të zgjidhet përmes një përfaqësuesi special të OKB-së, në këtë rast Marti Ahtisarit, i cili do të hartonte një plan gjithëpërfshirës, ku do të përfshiheshin të gjitha etnitë në Kosovë, por që kishte një element thelbësor të zgjidhjes dhe ai element thelbësor ishte shpallja e pavarësisë, që nënkuptonte qëllimin kryesor të të gjitha gjeneratave në Kosovë, pra, ditën e pavarësisë dhe shpalljes së Republikës së Kosovës.

Në këtë luftë u dëbuan 800 000 shqiptarë nga territoret e tyre, u vranë 15 000 persona, nga të cilët 2 400 luftëtarë të UÇK-së e të tjerët qytetarë të thjeshtë. Gjatë luftës janë zhdukur rreth 5 000 njerëz, fati i shumicës prej tyre është zbardhur deri në vitin 2007, por i madh ka mbetur numri i rasteve të pa gjetura.

Në Kosovë agresori pushtetar serb bëri krime kundër njerëzimit, të cilët ishin të përmasave aq të mëdha, sa që ka të bëjë me elementet e gjenocidit.

Gjenocidi është krim i planifikuar dhe i organizuar nga pushteti me qëllim të zhdukjes së gjurmëve të identitetit, zhdukjes së shenjave të kulturës shpirtërore dhe materiale, në mënyrë që të bëhet ndërprerja e zhvillimit normal të procesit historik në jetën e një populli.

Gjenocidi është vrasja e qëllimshme e njerëzve në baza etnike, nacionale, racore, religjioze ose (nganjëherë) politike, si dhe veprime të tjera të qëllimshme që çojnë në eliminimin fizik të ndonjë populli. Ndërkaq, në krimin kundër njerëzimit bëjnë pjesë: vrasja, shfarosja, marrja rob, dëbimi, burgosja, torturimi, dhunimi, ndjekja mbi baza politike, racore e fetare dhe veprimet e tjera jonjerëzore. Krimet në luftën e Kosovës përfshinin dëbimin e popullatës, masakrat, pastrimin etnik, dhunimet, plaçkitjet, helmimin e puseve, fshehjen e kufomave, fshirjen e identitetit, keqpërdorimin e civilëve dhe puna e dhunshme, shkatërrimin e vendbanimeve dhe minimin e terrenit. Krimi në Kosovë ishte masë e paraparë dhe e planifikuar nga Serbia, përkatësisht nga qarqet e saj politike, shkencore, kulturore dhe ushtarake. Masakrimet, vrasjet masive, dhunimet e vajzave dhe të grave të reja, djegiet dhe shkatërrimet masive të vendbanimeve, të ekonomisë dhe pronës nuk u mjaftonin forcave ushtarake, policore dhe paramilitare serbe, por për t'i humbur gjurmët e krimeve, ata hapnin varreza masive dhe individuale akoma të paidentifikuara në Kosovë dhe jashtë Kosovës. Ka shumë raste kur kufomat janë varrosur, por pas disa ditëve janë zhvarrosur dhe dërguar në vende të panjohura. Paramilitarët serbë merrnin me dhunë vajzat e reja shqiptare dhe i dërgonin në vende të

“Në luftë mund të ndodhë që dikush të flijohet, por edhe nëse mbetet vetëm një ushtar i gjallë, e ka për obligim që në vendbanimin e parë ta formojë ushtrinë dhe ta vazhdojë luftën deri në çlirimin përfundimtar”



caktuara, ku i dhunonin. Në mesin e të përdhunuarave ka pasur të mitura, studente, gra shtatzëna, gra të moshuara etj. Kishte raste që i dhunonin edhe para anëtarëve të familjes, burrit, fëmijës, babait, nënës etj. Në shumë raste, pas dhunimit, edhe i vritnin me qëllim të humbjes së gjurmëve. Shumë vajza rezistonin, por e pësonin dhe i vrisnin. Vajzat i merrnin në familje ose në kolonë përgjatë ikjes së popullatës.

Tek ndiqja me vëmendje dhe trishtim mediat se çfarë ndodhte në Kosovë gjatë agresionit kafshëror serb, të ruajtur në kujtesën e afërt më rivijnë piskamat e dhimbjes së vajzave kosovare, të cilat mes lotëve të dhimbjes shprehen se “ne jemi të vdekura, por të pakallura”. Drithëruese edhe sot pas 16 vitesh.

Në luftën e agresorit serb u vranë shumë të rinj, fëmijë. Sipas të dhënave të grumbulluara për numrin e fëmijëve të vrarë dhe të pagjetur, por të rënë edhe dëshmorë në Kosovë në periudhën janar 1998 - 12 qershor 1999 janë gjithsej 1 284 fëmijë shqiptarë deri 18 vjeç. Janë vrarë edhe shumë femra shqiptare. Sipas shënimeve,

të cilat posedohen nga autoritetet kosovare, në periudhën janar 1998 deri më 12 qershor 1999 në Kosovë janë vrarë ose zhdukur 1 721 femra të moshave të ndryshme. Disa prej tyre kanë rënë edhe dëshmore. Në luftë pësuan edhe shumë të moshuar dhe invalidë. Në bazë të të dhënave të grumbulluara, në Kosovë janë vrarë ose zhdukur 1 843 persona mbi moshën 65-vjeçare, që mund të konsiderohen pleq. Disa persona të moshuar kanë rënë si dëshmorë në altarin e lirisë.

17 Shkurti 2008, dita që ndryshoi statusin e Kosovës, dita e Deklaratës së Pavarësisë, dita e simboleve shtetërore shqiptare, dita e përmbylljes së amanetit të të gjitha gjeneratave për liri dhe pavarësi.

Pavarësia e Kosovës rrjedh mbi sakrificën e gjeneratave të tëra dhe rëndësia e saj historike është e jashtëzakonshme, sepse është e vulosur me gjakun e heronjve, dëshmorëve dhe martirëve të kombit. Ata janë rojet e institucioneve të shtetit të Kosovës, janë emblema më e rëndësishme e lirisë dhe demokracisë.





GJENERAL (R) PIRO AHMETAJ,
EKSPERT PËR SK, RAJONIN DHE NATO-N,
ZV/PRESIDENT I KËSHILLIT TË ATLANTIKUT

E kam ndjekur me përgjegjësi shtesë intervistën ekskluzive, që ish-gazetari i “Fox-News”, z. Tucket Carlson i mori nga bunkeri i Kremlinit, Presidentit Putin, ose sunduesit për 24 vjet të Rusisë.

Kjo intervistë, gjithsesi provokative është ndjekur nga qindra mijëra shikues në mbarë globin si dhe vijon të mbetet në krye të çështjeve për Kancelaritë, Institutet dhe personalitetet me peshë në, Washington, Bruksel, Londër, Berlin, etj. Prandaj, në kapacitetin e “Ekspertit të Sigurisë Kombëtare, Rajonin dhe NATO-n”, po paraqes një përmbledhje strategjike rreth kësaj interviste djallëzore, dëshpëruese dhe kërcënuese, njëherësh:

Paraprakisht, kjo ishte intervista e parë jo vetëm në hartën Euroatlantike (me 1 miliard banorë dhe me ½ e GDP-se botërore), qysh mbas sulmit ushtarak të Rusisë - Putiniste mbi sovranitetin e Ukrainës, më 24 shkurt 2022 (pasi 2 vitet e fundit Putini ka dhënë intervista vetëm për mediat ruse, kineze dhe kazake). Pra, dy vite mbas ofensivës ‘neo-naziste’ kundër sovranitetit të Ukrainës, rendit global dhe interesave Euroatlantike, Presidenti Putin doli nga “bunkeri i izolimit ndërkombëtar për të përsëritur gënjeshtër të rrezikshme (që nuk i beson kërkush, përfshi dhe vetë Ai) për Ukrainën, SHBA, NATO, MB, BE, Kinën, etj.

Thënë kështu, devijimin e intervistës NGA përgjegjësitë e sulmit barbar ndaj Ukrainës, TE një leksion akademik mbi “historinë mijërvjeçare të mëmës Rusi”, deri në ditët e sotme të “marrëdhënieve vëllazërore Rusi - Ukrainë”, i gjej jo vetëm cinike në përjasje, në kohë, strukturë dhe përmbajtje por njëkohësisht djallëzore dhe kërcënuese në raport me arsyet dhe pasojat kriminale të riciklmit të luftës ‘neo-naziste’.

Më konkretisht, si një skuth i stërvitur nga makineria e kimit (KGB-ja), nga 30 sekonda që kërkoi në hapje të intervistës, konsumoi më shumë se gjysmën e kohës, pra mbi 1 orë me historinë e lavdishme mijëra vjeçare, ku në mënyrë tinëzare Ukrainën e trajtoi si pjesë të Mëmës-Rusi. Ndërsa fushatat çnjerëzore të Katerina II, të Lenin-Stalinit si dhe gjatë 2 viteve të fundit, i “justifikoi” ku e ku më të buta krahasuar me ato të Hitlerit, Polakëve, etj., apo dhe të ‘ultra-neo-nazistëve’ (sipas tij) sot në Ukrainë”.

E thënë edhe më thjeshtë, pra për qytetarët që ndoshta do ishin apo janë të interesuar për historinë mijëra vjeçare të Rusisë, nuk ka arsye të dëgjojnë ish-oficerin e KGB-së, as politikanin skuth dhe as sundimtarin 25 vite të Kremlinit, por profesorët dhe akademikët në universitet e mirënjohura në Moskë e kudo gjetkë.

Parë kështu, sigurisht i bashkohem keqardhjes së strategjistëve/kolegëve dhe kritikëve në mediat perëndimore, për vetë faktin që në këtë intervistë, Putinit iu dha një platformë për të manipuluar. Prandaj, ndërsa kancelari Gjerman e quajti “qesharake”, zëdhënësja e KE-së, Massrali, e cilësoi me të drejtë: “gënjeshtër të vjetra, shtrembërime si dhe tregoi armiqtë të madhe ndaj Perëndimit”!

Së dyti, “ligji jam unë, historia e madhërishe me kombit, fillon dhe mbaron me mua”, thonë diktatorët. Asgjë ndryshe kësaj nuk tha edhe Putini në këtë intervistë. Pra, të gjithë paraardhësit përfshi moderatorin e mençur Gorbaçov, përjashtoj “prijedashësin” Jelsin, janë fajtorë jo vetëm për “shpërbërjen vullnetare të BRSS-së”, por edhe për “lëshimet e paarsyeshme” ndaj perëndimit, SHBA-së, NATO-s, BE-së. Përveç të tjerash, Ata, janë fajtorë edhe që i dhanë Ukrainës terrore dhe pozita të favorshme strategjike, që sipas Tij: “nuk kanë qenë kurrë pjesë e Ukrainës historike/natyrale!”.

Po ashtu, e gjej dalldisje delirante ri-konfirmimin e Tij, që: “as në 2014, as në 2022 nuk e nisi Rusia agresionin kundër Ukrainës, por vetëm ndërhyri ushtarakisht për të ndaluar luftën dhe mbrojtur vëllazërit e një besimi (ortodoks) nga ekstremistët neo-nazistë” që sipas tij “u duartrokitën jo vetëm nga Kanada”. Por në vijim, e bëri çorape edhe për faktin që, sipas Tij: “nazistët e rinj në Ukrainë po udhëhiqen nga një qytetar ukrainas, por me origjinë hebraike (presidenti Zelensky), babai të cilit ka luftuar kundër fashizmit!” Më keq akoma, për luftën kriminale në Ukrainë bëri fajtorë të vetme “politikën e zgjerimit” nga SHBA/NATO, duke provokuar përsëri rendin global si dhe kohezionin ndërmjet 31 vendeve të aleancës transatlantike.

Prandaj solli me cinizëm në kujtesë, ish-presidentin e Partisë Social-Demokrate në Gjermani në vitet 90: “një plak të mençur”, mbas shpërbërjes së ish-BRSS dhe Varshavës, që sipas Tij: “kishte kërkuar ndërtimin e një sistemi të përbashkët për sigurinë, përfshirë Rusinë”. Por ky zë si dhe “lëshimet e paarsyeshme” të ish-udhëheqësve rus të kohës, u refuzuan brutalisht nga perëndimi, pasi SHBA-ja, NATO-ja dhe BE-ja, fatkeqësisht vjuan edhe pas 1990 ta konsideronin Rusinë si fuqi armiqësore ndaj Aleancës Euroatlantike.

Së treti, me sforcën e një ariu të plagosur, hapi një pandorë të rrezikshme, p.sh për kufijtë shtetërore të Hungarisë me Ukrainën. Ndërsa me gjeite vrasësi shprehu pendesë për mos reagimin e Moskës, ndaj padrejtësive dhe vuajtjeve shekullore të vëllazërve Serb!; për në rastin e ndërhyrjes së NATO-s në Kosovë si dhe tolerimet e tepruara gjeopolitike të Jelsin-it (në fakt të Tij si Sekretar i SK-së, deri 1 muaj para se të pushtonte de-jure Kremlinin), kur Rusia dërgoi një Kompani të Motorizuar në aeroportin e Prishtinës.

Po ashtu intervista u dominua nga dinakëria për t’i frymëzuar

“Intervista djallëzore dhe dëshpëruese e Putinit”



bolshevikët e lajthitur, jo vetëm në Rusi, duke përsëritur se: “ndërhyrja ushtarake në Ukrainë në 2014 dhe 2022 ishte e imponuar, pasi Ukraina në NATO mbetet kërcënim serioz për interesat gjeopolitike të Rusisë”. Në fakt, kjo është gjithsesi gënjeshtër tinëzare, pasi: “në asnjë rast dhe për asnjë arsye, NATO nuk ka patur qëllime për të sulmuar ushtarakisht Rusinë!”.

Po ashtu, ndërsa nga njëra anë i bëri komplimente të ekzagjeruara leadership-it të Xhorxh Bushit të ri, nga ana tjetër turfullonte se: “kriza drejt luftës ishte frymëzuar në 2008, kur në Samitin e Bukureshtit, Ukraina dhe Georgjia morën statusin aspirant (derën e hapur) për në NATO”. Por vetëm për shkak të së vërtetës dhe si dëshmitar teknik në Bukuresht më duhet ta them se ky është një spekulim cinik, pasi marrëdhënia NATO-Ukrainë ishte ngritur në nivel Komiteti, që prej samitit të Uashingtonit në prill 1999!

Së katërti, e çmoj tërësisht vetë-diskredituese propagandimin për kohezionin e kombit të madh Rus rreth luftës barbare në Ukrainë. Kështu edhe pse (keq) përdori politikisht se: “Rusia është shtet kapitalist dhe s’ka më parti Komuniste”, në 25 vjet opozitën zyrtare e cilësoi si armike të kombit, ndërsa “SHBA-ja dhe perëndimin, sigurisht fajtorë që mbështesin këta terroristë”, ose opozitën zyrtare?!

Për ta çmontuar botërisht këtë gënjeshtër tinëzare, pra demagogjinë bolshevikë për unitetin e çeliktë të kombit rreth historisë së lavdishme, shpirtit Rus dhe leadershipit të Tij, do mjaftonte të përmendnim faktin se, për të dalë nga llogoret e Zaporizhias, Oblastës, Bakhmutit, Khersonit, etj., si dhe për të vijuar luftën kriminale deri në pushtimin e plotë të Ukrainës, Ushtria Ruse ka rekrutuar mbi 15,000 Nepalezë, pra ish-mercinarë maoist, me pagesë rreth 2000 dollarë në muaj?!

Ndërsa në komentet për Kinën, Putini u tregua si dhelpr/shkile, duke e promovuar Atë si “model suksesi të ekonomisë dhe për qasjen plotë kompromise”, si dhe ringjallur shpresën edhe pse ka marrë në mënyrë të përsëritur refuzimin për të tërhequr Pekinin në një aventurë/ front lufte ndaj Taivanit, pasi, kur vjen fjala për interesa gjeopolitike Kina nuk mund të jetë aleate e natyrshme me Rusinë kundër USA/NATO-s! Ndërsa është fakt, që në 2 vjet lufte Rusia jo vetëm mori refuzimin e Pekinit, por e ka nisur 2024 me një intensitet historik bashkëpunimi me SHBA-të, përfshi edhe takime bilaterale ushtarake!

Së pesti, pa e përmendur fare peshën kritike për paqen globale të SHBA-ve, marrëdhëniet me Rusinë, i ironizoi si dhe hodhi helm pikëpyetjesh mbi integritetin e Institucioneve dhe Presidentëve të SHBA-ve pasi sipas tij: “ndryshe konfirmojnë në takimet zyrtare, si p.sh. për (mos) zgjerimin e NATO-s deri afër kufijve të Rusisë; për traktatet e armëve bërthamore, etj., ndërsa në fakt, pushtetin e vendimmarrjes e ka CIA, etj.”.

Por edhe pse gjatë intervistës bënte “dhelprën e trimëruar” ndaj SHBA-së, MB-së, NATO-s, etj., në “gjuhën e trupit” dallohej qartësisht tmerrin nga humbja turpëruese që e pret Rusinë - Putiniste, jo vetëm në Ukrainë por dhe në përballjen me fuqinë e pakonkurueshme të aleancës transatlantike (SHBA/NATO/MB/BE). Kështu njëherë bënte viktimën, që iu ishte lutur Presidentëve të SHBA-ve, të mos vijonin më mbas 5 valëve të zgjerimit si dhe aktualisht për negociatat e paqes në Ukrainë, etj., ndërsa nga ana tjetër kërcënonte se: “Rusia po i modernizon, madje çdo ditë raketat supersonike/ndërkontinentale”!?

Gjithashtu, e quajti “propagandë të stisur” nga perëndimorët që: “mbas Ukrainës, Rusia planifikon të sulmojë ushtarakisht Poloninë, vendet Baltike, etj.”, e thënë ndryshe NATO-n (artikulli 5), duke shtuar se “as nesër as pasnesër, as kurrë”, pasi Rusia nuk ka të tilla qëllime, përveçse: “do të hakmerremi vetëm nëse sulmohen ushtarakisht integriteti dhe interesat jetike të Rusisë”!

Në fakt, jo vetëm perëndimorët e kanë të qartë që Ukraina nuk po lufton vetëm për integritetin e Saj, por edhe për sigurinë e vendeve të NATO-s si dhe për vlerat perëndimore. Prandaj, përkundër shashkave

të helmatisura të Putinit për të minuar kohezionin mes 31 vendeve të Aleancës si dhe mbështetjen e tyre konstante dhe të pakushtëzuar deri në fitoren e Ukrainës, vlen të përmendim se përveç 100 miliardë \$ armatime moderne gjatë 2022/23, Senati i SHBA-ve, po diskuton edhe 60 miliardë \$ si dhe mbi 40 miliardë nga vendet e tjera të NATO-s, pra 100 miliardë \$ edhe për 2024. Po ashtu zgjerimi me Finlandën dhe Suedinë, janë pjesë e “kundërofensivës strategjike të/për Ukrainën” mbas sulmit neo-nazist të Rusisë - Putiniste.

Në përmbledhje të sa më sipër, këtë intervistë sigurisht e gjej cinike, delikuede, dëshpëruese, të rrezikshme dhe të frikshme njëherësh. Kjo pasi në këtë intervistë Putini fajësoi tërë botën, pra SHBA-të, NATO-n, Perëndimin ndoshta dhe planetin e Marsit, por asnjë fjali dhe asnjë pendesë për përgjegjësitë e mbi gjysmë milionit të vrarë kriminalisht në Ukrainë; as për shpalljen në kërkim ndërkombëtar si kriminel lufte; as për koston mbi 9 trilion \$ për 2 vjet luftë (mbi 2.5 vjet GDP neto të Rusisë), as për rrezikun e daljes nga Këshilli Sigurimit/OKB si dhe as për izolimin dhe diskreditimin e Rusisë - Putiniste nga bota e qytetëruar, etj.

Prandaj, përfshi dhe përtej kritikave të ashpra ndaj gazetarit z. Carlson, këtë intervistë e çmoj njëkohësisht të dobishme. Kjo pasi iu tregoi kancelarive, Institucioneve si dhe jo vetëm opinionit euroatlantik, mbi gjendjen dëshpëruese dhe dalldisjen e frikshme (kamikase) të një mendje të deformuar (nga fuqia e mbi Pushtetit) që sundon barbarisht, prej 24 vjetësh Kremlinin.

Në SHITESË, gjithsesi nga kjo intervistë provokuese, shokuese, konspiracioniste, ose si të dëshironi quajeni, mundet të adresojmë edhe “tre rekomandime strategjike”, reciprokisht për NATO-n: Do duhet “të forcojë më tej kohezionin, duke mbështetur pa asnjë kompromis Ukrainën deri në fitoren ndaj Rusisë, por edhe për përmirësimin e fuqisë ushtarake (përfshi deterrence/afhtësitë shkrajuese) në mbrojtje të tërësinë territoriale të 31 vendeve anëtare si dhe interesave gjeopolitike të NATO-s”! Ndërsa si përgjigje e menjëhershme ndaj intervistës së Putinit, do të shërbejnë Konferenca e Sigurisë në Muni, Gjermani si dhe stërvitja “Steadfast Defender 2024”, e cila zhvillohet për t’ju përgjigjur një sulmi nga armiqët potencialë (Rusisë - Putiniste), në të cilën do të angazhohen rreth 90,000 trupa; mbi 50 asete strategjike detare, përfshi aeroplanmbajtëse, fregata, destroyerë, etj.; mbi 80 kapacitete ajrore si F-35, etj., avion luftarakë; helikopterë dhe dronë luftimi; mbi 1,100 automjete luftarake, duke përfshirë 166 tanke, 417 transportues të blinduar (APCs) si dhe 533 automjete luftimi të këmbësorisë (IFVs), etj.

Rajonin, kryesisht do duhet të shërbejë si mesazh euroatlantik ndaj Beogradit zyrtar: “për të mos vijuar të (keq) përdorohet për interesat e Moskës në Rajon; të mos e armatoset (me Mig29, raketa, dronë rus, etj.); të mos frymëzojë radikale të tipit Dodik në Bosnje si dhe grupet kriminale në Veriun e Kosovës, etj. E thënë më shkurt: “të mos kërcënojë me agresion ushtarak ndaj integritetit të Kosovës; status-quonë gjeopolitike si dhe investimin e SHBA/NATO për paqen, stabilitetin e rajonit të Ballkanit”!

Në planin (mbarë) kombëtar: “mesazhet e kësaj interviste, të mos i adresojmë me kakofoni bolshevikë, por me përgjegjësi të lartë shtetërore, jo vetëm për mbrojtjen e interesave kombëtare por edhe për promovimin e peshës që mban RSH në stabilitetin demokratik, forcimin e partneritetit strategjik me SHBA/NATO si dhe për integrimin Euroatlantik të 6 vendeve të Ballkanit perëndimor”.

Gjithsesi shpresoj që kjo intervistë t’iu shërbejë elitave mendjehapura, jo vetëm në 31 vendet e hapësirës euroatlantike: “për të punuar fort kundër rikthimit të gjakdhëdhjes shekullore”, duke kujtuar thirrjen ulëritëse: “njerëz qëndroni vigjilentë, paqja, siguria dhe demokracia nuk janë dhurata të përjetshme”.

Monumentet historike, dëshmi e trashëgimisë pa kufi

Monumenti është një lloj strukture tredimensionale, e krijuar në mënyrë eksplicite për të përkujtuar një person ose ngjarje të rëndësishme për një grup social si pjesë e kujtimit të kohëve historike ose trashëgimisë kulturore, për shkak të rëndësisë së tij historike, politike, teknike, artistike ose arkitekturore.

Shembuj të monumenteve përfshijnë statujat, (luftën) përmendoret, ndërtesat historike, vendet arkeologjike dhe pasuritë kulturore.

Monumentet historike shqiptare

Historia e monumenteve shqiptare, si shprehëse e historisë së krijuesve të tyre, e ka zgjidhur me kohë qëndrimin kundrejt



bashkësive të tjera kulturore.

Monumentet shqiptare, krahas vlerave në planin kombëtar, shpesh mbartin vlera në planin europian, qoftë si dëshmi autentike të kulturës vendase, apo si interpretime madhore gjinish, brenda hapësirash të gjera kulturore, në të cilat u përfshinë natyrshëm shqiptarët në shekuj.

Vendndodhja e monumenteve dhe përmendoreve ndryshon prej vendit në vend. Në vendet urbane, në qytete, zakonisht gjendet një monument që përjetëson kujtimin e heroit, të cilit i është ngritur monumenti, por gjithashtu edhe luftën e fundit. Zakonisht heroi ose është nga ai qytet ose nga rrethina. Shpeshherë, vetë vendndodhja e monumentit është vendngjarje me rëndësi historike, siç mund të jetë vendi ku heroi kishte vdekur.

Vlerë kulturore-historike bëhet çdo vepër objekt, i cili ruan në vetvete kujtimin për të kaluarën, e cila do të ishte e rëndomtë sikur të mos ndodhnin ngjarje të rëndësishme që i kanë dhënë vullë kohës. Në vendet e zhvilluara evropiane, vënia në mbrojtje dhe restaurimi i monumenteve, që shfaqet qysh në fillimet e shek. XIX, është alfa dhe omega e një veprimtarie sistematike kushtuar memorizimit të kulturës materiale e shpirtërore të një populli.

Për të shkatërruar trashëgiminë kulturore dhe historike të një vendi, ose të një kombi, mjaft të shohim çfarë ka ndodhur në Afganistan, ku në fillim të këtij shekulli talebanët kanë shkatërruar me mina dhe tanke, monumente prej më shumë se 1700 vjeçare. Raste të tjera janë Iraku dhe Siria, ku i ashtuquajturit “shteti islamik” (ISIL) ka shkatërruar qytetin e vjetër sirian Palmyra dhe monumentet e vjetra të tij. Mënyra tjetër e shkatërrimit të trashëgimisë kulturore dhe historike të një kombi është pakujdesia ose mosinteresi zyrtar për ruajtjen e trashëgimisë kulturore dhe historike të një kombi.

Ka ndodhur dhe ndodh, që në kohë lufte dhe konfliktesh, shqiptarët e dinë këtë më mirë se shumë popuj të tjerë, monumentet dhe simbolet që përfaqësojnë identitetin dhe rrënjët e përbashkëta të një kombi, bëhen objekte sulmesh dhe dhune me qëllim për t'i zhdukur ato nga faqja e dheut, e me to edhe identitetin kulturor dhe historik të një populli.

“Trashëgimia kulturore e historike është pasqyrë e vlerave dhe e nivelit kulturor të një populli, ku përmes kujtesës historike e njohim dhe e nderojmë të kaluarën, traditën, rrënjët, gjurmët ndër shekuj. Trashëgimia kulturore e secilit vend del nga kultura, traditat, zakonet dhe historia e banorëve të atij vendi, prandaj, duhet ruajtur dhe mbrojtur për gjeneratat e ardhshme!”

Secili monument kulture ka individualitetin dhe rëndësinë



dokumentare historike të pakrahasueshëm me njëri - tjetrin. Monumenti ruhet fizikisht me ligj dhe mbrohet shkencërisht nga dëmtimet në kohë prej institucionit të posaçëm shtetëror përmes restaurimit, që monumenti të vazhdojë të jetojë me gjenerata në mes të shoqërisë.

Monumentet e kulturës së një qyteti e kombi janë simbole të rëndësishme që tregojnë vlerat materiale, shpirtërore dhe zhvillimin në shekuj dhe vite. Monumentet e kulturës jo vetëm në perëndim, por edhe në vendet ish-komuniste kanë patur dhe vazhdojnë të kenë një vëmendje të veçantë.

Të gjithëve që na ka rënë rasti të vizitojmë vende të ndryshme të kontinentit tonë, dhe “shkrihemi”, duke treguar një foto të bërë në këto monumente, të cilat mezi presim t'i publikojmë në foto, në rrjetet sociale. për t'u treguar të gjithëve se kemi qenë në “filan” vend apo në “filan” monument të kulturës europiane.

Po përse nuk duhet që këto ‘institucione shpirtërore’ dhe

materiale të një kombi të mos marrin vendin që iu takon edhe tek ne, të bëhen të vlefshëm deri të shenjtë për të gjithë ne?!

Zhvillimet sociale dhe urbane mbas viteve ‘90-të, zhvillimi dhe “nënvleftësimi” i këtyre monumenteve, mund të takohet edhe në vende të tjera ish-komuniste por tek ne, në këto vite pati përmasa alarmante duke i kthyer edhe në “kioska” rakie e qoftesh dhe duke u marrë me to gjithkush, qoftë edhe pa një formim dhe edukim në këtë fushë. Monumentet historike, kulturore dhe natyrorë janë vlerë kombëtare për të cilët duhet të tregojmë kujdes të veçantë, si një tregues i identitetit njerëzor dhe kulturor, trashëgimi e pakontestueshme ndër breza.

Memoria historike kalon nëpër monumente, të cilët sjellin në kohëra të ndryshme fakte dhe realitete të autenticitetit të një kombi, ndaj rikonstruksioni dhe mirëmbajtja e këtyre vlerave duhet të jetë prioritet i institucioneve përgjegjëse.



PËRSHTATI: MIMOZA GOLIKJA

“Shqipëria është në listën e 2/3 të anëtarëve të NATO-s që ka përmbyshur angazhimin me vendosjen e 2% të GDP-së në funksion të sigurisë dhe mbrojtjes”. Në samitin e Uashingtonit në korrik, pjesa më e madhe e aleatëve do të sigurohet, gjithashtu, që të ketë plotësuar këtë kusht, pasi tashmë 2% nuk është më një tavan për vendet e NATO-s por një dysheme nga ku fillon investimi në Mbrojtje. Kjo shihet nga të gjitha vendet anëtare si një kusht në dritën e situatës aktuale dhe për t’u bërë ballë sfidave në fushën e sigurisë dhe ky është synimi aleat gjithashtu.

Ndërsa vendet anëtare po bëjnë përpjekjet maksimale për të shtuar shpenzimet e tyre në Mbrojtje, Shqipëria është një ndër vendet që ka bërë përparim lidhur me 2% e shpenzimit në Mbrojtje dhe ajo është krenare për hapat e sigurt që po hedh në këtë drejtim dhe jo vetëm.

Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi ka theksuar gjithmonë vendosmërinë e Shqipërisë për përmbyshjen e detyrimeve ndaj Aleancës, si rritja e nivelit të shpenzimeve të mbrojtjes në 2% të PBB dhe shpenzimeve minimalisht prej 20% të këtij buxheti për modernizimin e Forcave të Armatosura me pajisjet kryesore ushtarake, si pajisja me mjete moderne si raketa “Javelin”, helikopterë “Black Hawk”, dronë “Bayraktar” etj.

“Sapo kemi filluar të ndërtojmë flotën e helikopterëve ‘Black Hawk’. Dy tashmë janë në Shqipëri, po punojmë për të arritur në 6, në afatmesëm. Do të vijnë dronët ‘Bayraktar’ për pak javë. Më 4 mars kemi inaugurimin, ditën e hapjes së bazës ajrore taktike të NATO-s në Shqipëri, në Ballkanin Perëndimor, e cila ndodhet në Kuçovë. Aty do të kemi edhe avionë luftarak nga vendet aleate të NATO-s që do të bëjnë një demonstrim. Le ta quajmë dhe demonstrim force, nuk ka vend për ta fshehur, pasi bota nuk është më normale dhe nuk dihet kur do të rikthehet në normalitetin që ka qenë dikur. Ne do të përgatitemi për më të keqen, por do të shpresojmë për më të mirën. Jo vetëm do të shpresojmë por do ta shkuraejmë të keqen”, - deklaroi ministri i Mbrojtjes z. Peleshi, ndërsa ministrat e Mbrojtjes aleate ishin mbledhur në Bruksel në takimin e tyre të parë ministror për vitin 2024.

Ministri Peleshi ka nënvizuar vendosmërinë e Shqipërisë për të vijuar kontributin ushtarak përmes pjesëmarrjes në misionet dhe operacionet e NATO-s. “KFOR-i është këmba e NATO-s aty, që duhet ta fuqizojmë dhe në Bosnjë është misioni i BE-së, ‘Altea’”, - tha ministri Peleshi, teksa iu referua situatës në Kosovë dhe në rajon. “Do të dërgojmë së shpejti një togë në Bosnje”, ndërsa vijoi më tej me misionet e tjera në krahun Lindor të Aleancës, ku Shqipëria është pjesëmarrëse me kontributin e saj. “Kemi dërguar një togë në Bullgari për të forcuar krahun lindor. Gjithashtu, do të dërgojmë në Rumani një kompani me 100 ushtarë sapo të na hapet drita jeshile”. Edhe pse konfliktet janë prezent në rajon dhe Europë, ministri Peleshi është besimplotë tek Aleanca më e fuqishme në botë siç është NATO. “Ka një garanci shumë të madhe që është prezenca e NATO-s. Kosova ka NATO-n prezente këmbëkryq dhe të gatshme për çdo agresion që mund të vijë nga Veriu. Ne planifikojmë të ngremë sisteme të reja që nuk i kemi pasur më parë. Duke filluar nga ky vit do të implementojmë sistemin e mbrojtjes anti-dron, jo vetëm për infrastrukturën ushtarake, por edhe civile, porte, aeroporte, hidrocentrale.

Ministria e Mbrojtjes dhe Forcat e Armatosura po punojmë me SHBA-në për të kompletuar mbrojtjen kundërajrore, jo sepse ka një kërcënim me probabilitet të lartë për Shqipërinë, pasi jemi një aleat i NATO-s dhe askush nuk mund të guxojë të prekë 1 metër katror të Shqipërisë. NATO është gati



të mbrojë stabilitetin në Ballkanin Perëndimor, dhe në çdo centimetër aleat”. Shpenzimet e mbrojtjes të NATO-s, 600 miliardë dollarë që nga 2014 Ndërsa përgatitet për të pritur Samitin e NATO-s, që do të mbahet në Uashington në korrik 2024, Aleanca ka njoftuar se ka bërë përparimin historik në shpenzimet e mbrojtjes. Vitin e kaluar, është parë një rritje e paprecedentë prej 11% në të gjithë aleatët evropianë dhe në Kanada, ndërsa këtë vit, pritet që 18 aleatë, një numër rekord, të shpenzojnë 2% të PBB-së së tyre në mbrojtje. Që nga vitin 2014, aleatët evropianë dhe Kanadaja kanë shtuar më shumë se 600 miliardë dollarë amerikanë për mbrojtjen, gjë që tregon një përparim të vërtetë.

Publikimi nga Sekretari i Përgjithshëm i këtyre shifrave më të fundit të shpenzimeve të mbrojtjes të NATO-s, (shtimi i më shumë se 600 miliardë

NATO mbështet sovranitetin dhe integritetin territorial të Gjeorgjisë



marrëdhënie me të, kur ajo u bashkua me Këshillin e Bashkëpunimit të Atlantikut të Veriut. Ky forum për dialog u pasua në vitin 1997 nga Këshilli i Partneritetit Euro-Atlantik, i cili bashkon të gjithë aleatët dhe vendet partnere në zonën euro-atlantike. Bashkëpunimi praktik dypalësh filloi kur Gjeorgjia iu bashkua Partneritetit për Paqe (1994) dhe u thellua pas “Revolucionit të Trëndafilave” në 2003, kur qeveria e re shtyu për reforma më ambicioze.

Forcimin e lidhjeve, Gjeorgjia aspiron anëtarësimin në Aleancë

Gjeorgjia është një nga partnerët më të ngushtë të NATO-s dhe ajo aspiron të anëtarësohet në Aleancë. Midis NATO-s dhe Gjeorgjisë është zhvilluar një gamë e gjerë bashkëpunimi praktik, duke mbështetur përpjekjet për reforma të Gjeorgjisë dhe synimin e saj për anëtarësimin eventual në NATO. Vendi kontribuon në Operacionin “Sea Guardian” të udhëhequr nga NATO dhe

dollarëve për mbrojtjen, nga aleatët evropianë dhe Kanadaja) tregon për një rritje gjashtëfish që nga viti 2014, kohë kur vetëm tre aleatë kishin arritur objektivin e 2% të GDP-së. “Sot mund të shpall shifrat tona më të fundit. Që nga premtimi i investimeve në vitin 2014, aleatët evropianë dhe Kanadaja kanë shtuar më shumë se 600 miliardë dollarë amerikanë për mbrojtjen. Viti i kaluar pa një rritje të paprecedentë prej 11% në të gjithë aleatët evropianë dhe në Kanada. Këtë vit, unë pres që 18 aleatë të shpenzojnë 2% të PBB-së së tyre për mbrojtjen. Ky është një numër tjetër rekord dhe një rritje gjashtëfish nga viti 2014, kur vetëm 3 aleatë arritën objektivin. Në vitin 2024, aleatët e NATO-s në Evropë do të investojnë një total prej 380 miliardë dollarësh amerikanë në mbrojtje. Për herë të parë, kjo arrin në 2% të PBB-së së tyre të kombinuar. Pra, ne po bëjmë përparim të vërtetë. Aleatët evropianë po shpenzojnë më shumë. Megjithatë, disa aleatë kanë ende rrugë për të bërë. Sepse ne ramë dakord në Samitin e Vilniusit që të gjithë aleatët të investojnë 2% dhe ky 2% është një minimum”, u shpreh Shefi i NATO-s Stoltenberg.

Në vitin 2014, aleatët e NATO-s në Evropë investuan 1.47% të PBB-së së tyre kolektive në mbrojtje. Kjo shifër është rritur në mënyrë të qëndrueshme gjatë një dekade dhe do të arrijë në 2% në 2024.

NATO tashmë aleanca më e fuqishme ushtarake dhe politike në botë nuk ka lejuar asnjë sulm ushtarak kundër çdo aleati të saj për 75 vjet dhe këtë ajo e ka bërë, sepse që në krijim ka absolutisht të qartë Nenin 5, gurthemelin e saj, bindjen nga të gjithë anëtarët në çdo kohë, se ajo është atje për të mbrojtur aleatët, se “një sulm ndaj njërit do të shkaktojë përgjigjen nga e gjithë Aleanca”, dhe për sa kohë që NATO qëndron pas këtij mesazhi, ajo parandalon çdo sulm ushtarak ndaj çdo anëtare. Qëllimi i NATO-s është të parandalojë luftën, të ruajë paqen, të parandalojë sulmin dhe ajo e ka bërë këtë me sukses për dekada. Parandalimi dhe mbrojtja e Aleancës është më e besueshme se kurrë, çdo aleat është në mbrojtje të njëri-tjetrit, në gjithçka që rrit sigurinë e të gjithëve përballë sfidave dhe rreziqeve.

NATO ka aftësitë dhe vendosmërinë për të siguruar dhe mbrojtur të gjithë aleatët. Që nga viti 2014, Aleanca ka fuqizuar në mënyrë të konsiderueshme mbrojtjen kolektive, ajo ka përf forcimet më të forta mbi mbrojtjen kolektive në dekada e shkaktuar nga aneksimi i paligjshëm i Krimesë nga Rusia, por që gjithashtu ishte një vendim i aleatëve të saj në vitin 2014, “meqenëse bota ka ndryshuar dhe u bë më e rrezikshme, ishte e nevojshme që NATO të përgjigjej”. NATO vazhdon të investojë në mbrojtje, të përshtatet, të sigurojë që asnjë aleat të mos sulmohet, por në asnjë rast NATO nuk minon besueshmërinë e parandalimit të Aleancës dhe kjo ka të bëjë edhe me aftësitë në të cilat po investon si dhe me mënyrën se si komunikon. NATO nuk provokon konfliktin, ajo parandalon konfliktin tashmë me sukses për 75 vjet.

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Jens Stoltenberg u takua me kryeministrin gjeorgjian Irakli Kobakhidze në Bruksel, më 21 shkurt 2024 për të diskutuar forcimin e mëtejshëm të partneritetit afatgjatë të Aleancës me Gjeorgjinë. Sekretari i Përgjithshëm theksoi se Gjeorgjia është një partner i ngushtë dhe përsëriti mbështetjen e plotë të NATO-s për sovranitetin dhe integritetin territorial të Gjeorgjisë. “NATO vazhdon t’i bëjë thirrje Rusisë që të anulojë njohjen e territoreve gjeorgjiane si shtete të pavarura”, - tha Stoltenberg. “Çdo kërcënim nga Rusia për të aneksuar rajonet e pushtuara të Gjeorgjisë është i papranueshëm”.

Përpara takimit të Komisionit NATO-Gjeorgji, i cili diskutoi partneritetin e NATO-s me Gjeorgjinë dhe sigurinë rajonale, Sekretari i Përgjithshëm përgëzoi Gjeorgjinë për pritjen e mijëra refugjatëve ukrainas dhe ofrimin e mbështetjes thelbësore humanitare dhe financiare për Ukrainën. NATO po rrit bashkëpunimin e saj me Gjeorgjinë në fusha të tilla si menaxhimi i krizave, siguria kibernetike, inxhinieria ushtarake dhe komunikimet e sigurt. Stoltenberg i kërkoi Gjeorgjisë të vazhdojë dhe të përshpejtojë reformat e brendshme dhe të mbështesë vlerat demokratike në rrugën e saj drejt anëtarësimit të plotë në familjen euroatlantike. “NATO do të vazhdojë të qëndrojë pranë jush ndërsa punoni drejt përmbyshjes së këtyre aspiratave”, - tha Sekretari i Përgjithshëm, në deklaratën e përbashkët për shtyp me kryeministrin e Gjeorgjisë, Irakli Kobakhidze.

“Këtë javë, ne shënojmë përvjetorin e dytë të pushtimit të plotë të Ukrainës nga Rusia. Tërheqja e Ukrainës nga Avdiivka tregon se situata në fushën e betejës është jashtëzakonisht e vështirë. Por ukrainasit i kanë tejkaluar pritshmëritë vazhdimisht dhe NATO vazhdon të qëndrojë me Ukrainën”. Vetëm në ditët e fundit, aleatët kanë njoftuar paketa të reja të mbështetjes ushtarake me vlerë miliarda euro, përfshirë për mbrojtjen ajrore, municione artilerie dhe pajisje F-16. “Partnerët e NATO-s po luajnë gjithashtu një rol kyç, dhe unë mirëpres që Gjeorgjia po ofron ndihmë humanitare dhe financiare dhe po pret mijëra refugjatë ukrainas”, - tha Stoltenberg. Ai theksoi gjithashtu se siguria në rajonin e Detit të Zi, ka një rëndësi të madhe për Gjeorgjinë dhe se lufta e Rusisë kundër Ukrainës paraqet rreziqe thelbësore për lirinë e lundrimit si dhe ndikon në sigurinë ushqimore në mbarë botën. “Kështu që unë mirëpres përpjekjet e aleatëve që punojnë për çminimin e Detit të Zi, duke e bërë atë më të sigurt për lundrimin dhe tregtinë. Në takimin tonë të sotëm do të diskutojmë gjithashtu partneritetin ndërmjet NATO-s dhe Gjeorgjisë dhe si ta zhvillojmë atë më tej. Unë mirëpres përparimin e bërë në fusha si menaxhimi i krizave, siguria kibernetike, inxhinieria ushtarake dhe komunikimet e sigurt”, - tha Stoltenberg.

Sekretari i Përgjithshëm përgëzoi Gjeorgjinë për marrjen e statusit kandidat në BE. “Tani është e rëndësishme që Gjeorgjia të vazhdojë dhe të përshpejtojë reformat e brendshme dhe të mbështesë vlerat demokratike”, - tha ai. “Ne duam të shohim Gjeorgjinë të lëvizë në drejtimin e duhur, drejt më shumë demokraci dhe prosperitet. Drejt anëtarësimit të plotë në familjen euroatlantike. NATO do të vazhdojë të qëndrojë pranë jush ndërsa punoni drejt përmbyshjes së këtyre aspiratave”, - tha Stoltenberg.

Gjeorgjia rifitoi pavarësinë në vitin 1991. Një vit më pas, NATO vendosi

bashkëpunon me aleatët dhe vendet e tjera partnere në shumë fusha të tjera. Ndërkohë bashkëpunimi i Gjeorgjisë me NATO-n është reciprokisht i dobishëm dhe Paketa thelbësore NATO-Gjeorgji (SNGP) është mjeti kryesor për bashkëpunimin praktik midis Gjeorgjisë dhe NATO-s. E nisur për herë të parë në vitin 2014, paketa synon të forcojë aftësitë mbrojtëse të Gjeorgjisë në përputhje me standardet e NATO-s dhe të ndihmojë Gjeorgjinë të përparojë në përgatitjet e saj për anëtarësimin eventual në NATO. Paketa synon të mbështesë objektivat e Gjeorgjisë në këtë fushë. Në vitin 2020, u krye rishikimi i plotë i SNGP-së nga NATO së bashku me Ministrinë e Punëve të Jashtme, të Mbrojtjes dhe të Brendshme të Gjeorgjisë, si dhe me Forcat e Mbrojtjes Gjeorgjiane dhe Rojet Bregdetare. Ky rishikim çoi në një paketë thelbësore të përmirësuar NATO-Gjeorgji, e cila u miratua nga ministrat e Jashtëm në dhjetor 2020. Paketa e përmirësuar vazhdon të përfshijë fusha të shumta (ajër, tokë, det, hapësirë kibernetike) dhe përfshin aktivitetë mbështetëse në taktike, në nivele peracionale dhe strategjike, duke përfshirë kryerjen e stërvitjeve të rregullta të përbashkëta NATO-Gjeorgji.

SNGP i përmirësuar përbëhet nga 16 iniciativa, tre prej të cilave u shtuan në vitin 2020. Këto tre iniciativa kanë për qëllim të mbështesin Gjeorgjinë në zhvillimin e një kapaciteti mjekësor ushtarak të dislokueshëm; për të përmirësuar kapacitetin e trajnimit të gjuhës angleze të Gjeorgjisë; dhe për të përmirësuar sistemin e kodifikimit dhe standardizimit, i cili do të sigurojë një nivel edhe më të lartë të ndërveprimit të projekteve dhe programeve të reja të mbrojtjes gjeorgjiane me kërkesat e NATO-s. Për më tepër, siç u njoftua në Samitin e Vilnius 2023, paketa e zgjeruar ka zbatuar iniciativa të reja në fushat e menaxhimit të krizave, sigurisë kibernetike, inxhinierisë ushtarake dhe komunikimeve të sigurt, si dhe në fushat e objekteve të trajnimit dhe të mbrojtjes kimike, biologjike, radiologjike dhe bërthamore (CBRN).

Niveli i ambicies për iniciativat e vazhdueshme është rritur gjithashtu, përfshirë Qendrën e Përbashkët të Trajnimit dhe Vlerësimit dhe Shkollën e Ndërtimit të Institucioneve të Mbrojtjes. Këto nisma synojnë të sigurojnë komunikimet midis Gjeorgjisë dhe NATO-s, të forcojnë kapacitetet e mbrojtjes kibernetike të Gjeorgjisë dhe të përmirësojnë aftësitë ushtarake të vendit (tokësore, ajrore dhe detare). Nismat e rinovuara të aviacionit dhe detit synojnë gjithashtu të sigurojnë që Gjeorgjia të ketë një ndërgjegjësim më të mirë të situatës. Për të gjitha këto nisma, të reja apo të përditësuara, Gjeorgjia dhe NATO kanë rënë dakord për shtetet përfundimtare me plane konkrete dhe të detajuara zbatimi për vitet e ardhshme.

Qendra e Përbashkët e Trajnimit dhe Vlerësimit NATO-Gjeorgji në Gjeorgji pret stërvitje të drejtpërdrejta dhe të simuluar trajnimi dhe certifikim për njësitë ushtarake nga vendet aleate dhe partnere. Stërvitja më e fundit NATO-Gjeorgji u zhvillua në mars 2022 dhe ajo e ardhshme është planifikuar të mbahet në mars 2025. Aleatët kanë siguruar financimin për një numër automjetesh për Qendrën.

Për ju që jeni si unë, Grua...

Gratë më të famshme të botës, si këngëtare, aktore, fituese të çmimit “Nobel” kanë për të thënë diçka për mua, ty, ne. Fjalët janë një forcë e fuqishme. Ato mund të ndryshojnë historinë, të mobilizojnë ushtritë dhe të fillojnë revolucionet.

Gra që në rrugëtimin e tyre janë përplasur fort pas toke, por ia kanë dale të ngrihen dhe me kokën lart janë përballur me erëra të forta, duke i bërë sfidë gjithçkaje dhe gjithkujt që përpiket të ndalojë misionin e saj për jetën, që jeta të jetojë”.

Disa prej mesazheve të grave që jeta i sfidoi në dimensione të ndryshme.



Malala Yousafzai, aktiviste dhe fituese e çmimit “Nobel”, 2014:
“Ne nuk mund të kemi sukses, kur gjysma prej nesh pengohen të ecin përpara.”



Gillian Anderson, aktore dhe aktiviste

“Feminizmi nuk ka të bëjë me rritjen profesionale të grave, ato (gratë) janë tashmë të forta, por është ndryshimi i mënyrës se si bota e percepton këtë forcë.”



Annie Lennox, këngëtare dhe aktiviste politike

“Ne të gjithë luftojmë mbi atë që ka etiketën ‘feminizëm’, por për mua ka të bëjë me fuqizimin. Nuk ka të bëjë me të qenit më të fuqishëm se burrat, ka të bëjë me të drejtat e barabarta në mbrojtjen, mbështetjen, drejtësinë. Bëhet fjalë për gjëra shumë themelore. Nuk është një simbol sikundër një artikull i modës”.



Bette Davis, aktore

“Kur një burrë jep mendimin e tij ai është një zotëri. Kur një grua jep mendimin e saj, për fat të keq shpesh quhet e përdalë.”



Madeleine Albright, politikane

“Ka një vend të veçantë në ferr për gratë që nuk ndihmojnë gratë e tjera.”



Rebecca West, shkrimtare

“Unë vetë nuk kam qenë në gjendje të zbuloj saktësisht se çfarë është feminizmi. Unë vetëm e di se njerëzit më quajnë feministe sa herë që unë shpreh ndjenja që më dallojnë nga një çerdhe.”



Hillary Clinton, politikane

“Unë besoj se të drejtat e grave dhe vajzave janë biznesi i papërfunduar i shekullit të 21-të.”



Beyoncé, këngëtare

“Kush e drejton botën? Vajzat!”



Maya Angelou, shkrimtare

“Unë jam feministe. Unë jam një femër dhe do të ishte budallallëk po të mos isha në anën time.”



Kate Nash, këngëtare

“Feminizmi nuk është fjalë e ndyrë, por mbi të gjitha barazi.”



Michelle Obama, ish-zonja e parë e Amerikës

“Asnjë vend, kurrë nuk mund të lulëzojë me të vërtetë, nëse e mbyty potencialin e grave të tij dhe i privon vetes kontributet e gjysmës së qytetarëve të tij.”



Angelina Jolie, aktore dhe aktiviste

“Gratë ende trajtohen si çështje dytësore. Është akoma shumë e pranuar që udhëheqësit injorojnë të vërtetat e pakëndshme... Gratë, ne e dimë, janë të parat që preken nga lufta dhe të fundit që duhet marrë parasysh kur mbaron.”



Antonella Gambotto-Burke, gazetare

“Vetëm nëpërmjet vajzës sime kam arritur të kuptoj se një jetë pa feminitet - pa mister, emocion, butësi dhe forcën e brendshme e dashurinë e gruas, nuk është aspak jetë.”



Një element bazë për shmangien e gabimeve drejtshkrimore është ngritja e ndërgjegjes dhe kulturës gjuhësore të secilit prej nesh, duhet të gjithë të mundohemi të shkruajmë pa gabime dhe shtrembërime, të cilat po e tjetërsojnë gjuhën gati të pakuptueshme ose me disa kuptime, pse jo dhe gjuhë konvencionale.

Çdo individ e ka për detyrë të bëjë çmos për mbrojtjen dhe zbatimin e drejtë të normave dhe rregullave gjuhësore.

Një kulturë paqeje mund të ndërtohet vetëm në një hapësirë, ku secili ka të drejtë të përdorë plotësisht dhe lirisht gjuhën e tij amtare në të gjitha rrethanat e ndryshme të jetës. Kjo ditë është një mundësi për të promovuar diversitetin gjuhësor dhe kulturor dhe për të punuar për të ruajtur këto dallime në kultura dhe gjuhë që promovojnë tolerancën dhe respektin për të tjerët.

Më 21 shkurt 2022, UNESCO shënon Ditën Ndërkombëtare të Gjuhës Amtare të 23-të për të promovuar diversitetin gjuhësor global dhe edukimin shumëgjuhësh.

Diversiteti gjuhësor është çelës për ndërtimin dhe ruajtjen e shoqërive integrale, të hapura, të larmishme dhe pjesëmarrëse. Gjuhët përcjellin informacion dhe njohuri, duke promovuar në këtë mënyrë prosperitetin, ndryshimin shoqëror dhe zhvillimin e qëndrueshëm. Shoqëritë shumëgjuhëshe dhe multikulturore ekzistojnë nëpërmjet gjuhëve të tyre, të cilat transmetojnë dhe ruajnë njohuritë dhe kulturat tradicionale në mënyrë të qëndrueshme.

Njohja dhe respektimi i diversitetit gjuhësor dhe kulturor janë thelbësore për bashkëjetesën paqësore.

Termi gjuhë amtare zakonisht i referohet gjuhës së parë të mësuar, atë që flasim që në vegjëli. “Gjuha amtare është një gjuhë e mësuar nga folësi në fëmijërinë e hershme pa udhëzim zyrtar. Sipas Kluge-së, fjala ndoshta është krijuar sipas modelit të latinishtes lingua materna (fjalë për fjalë: “gjuha nga ana e nënës”).

Gabime drejtshkrimore gjenden edhe në tekstet shkollore, si dhe në shumë dokumente të tjera, të cilat bëhen publike nga organizatat dhe mekanizmat tjerë në vendin tonë.

Gjuha shqipe ka përparuar shumë këta njëqind vjet edhe për sa i përket shkallës së përpunimit të saj. Nga gjuhë me disa variante letrare e dy gjuhë zyrtare (toskërishtja në Shqipëri, gegërishtja në trojet shqiptare në ish-Jugosllavi), prej vitit 1972 ajo është ngritur në shkallën e gjuhës letrare kombëtare, të pranuar nga të gjitha pjesët e kombit. Ishte Konsulta e Prishtinës e prillit 1968 ajo që hodhi hapin e madh të bashkimit gjuhësor, kur intelektualët shqiptarë të atjeshëm, të udhëhequr nga motoja “një komb – një gjuhë letrare”, shpallën se shqiptarët në Jugosllavi pranonin “si gjuhë të vetën letrare gjuhën letrare të vendit ëmë”.



Gjuha Amtare, identifikim, vlerë, histori kombëtare



Kongresi i Drejtshkrimit e sanksionoi këtë vendim, duke shënuar në këtë mënyrë fundin e periudhës kur shqipja shkruhej në disa variante dhe fillimin e jetës kombëtare të shqipes letrare. Periudha nga Kongresi i Drejtshkrimit e deri më 1990 vlerësohet nga të gjithë si periudha e përpjekjeve për zotërimin dhe përdorimin e normave të gjuhës letrare në të gjithë veprimtarinë ligjëruese të shkruar e të folur. Në trojet shqiptare të ish-Jugosllavisë Konsullata u vuri detyrë shkollës enteve botuese, redaksive e gazetave dhe administratës zbatimin e normën letrare, kurse në Shqipëri, zbatimi i normave të gjuhës letrare nga shkolla, entet botuese dhe administrata shtetërore u bë i detyrueshëm me një vendim të vitit 1978 të Këshillit të Ministrave.

Pas viteve '90, me përmbysjen e sistemit politik dhe kalimin në

pluralizëm, u vu re një rënie e theksuar e kujdesit për gjuhën nga të gjithë, nga shteti e shoqëria, që u pasua edhe me kontestime të gjuhës letrare e me përpjekje për krijimin e gjuhëve të reja letrare.

Si pasojë e mungesës së kujdesit shtetëror për gjuhën, në botimet, në gazetat e revistat, në televizionet dhe në dokumentacionin zyrtar vërehen shkelje të pafalshme të normave të gjuhës letrare. Më e dukshme kjo dukuri e shëmtuar është në fushën e fjalorit, ku vërehet një vërshim i fjalëve të huaja të panevojshme, të cilat po e drunjëzojnë dhe po e venitin gjuhën, duke u zënë vendin dhjetëra fjalëve të bukura shqipe që përdoren në kontekste të ndryshme sintaksore, edhe në fushën e drejtshkrimit mospërdorimi i shkronjave ë dhe ç është tregues i injorancës kompjuterike, po edhe mungesë e respektit për alfabetin tonë, për shkronjat e të cilit është derdhur gjak. Në televizione po sundojnë modele aksentologjike të huaja. Ky model i huaj theksimi ka prishur edhe melodinë dhe metrikën e frazës.

Mjaft lëshime hasim në përdorimin e gjuhës shqipe që s'janë vetëm mungesë dijesh gramatikore, por mospërfillje dhe pavetëdije për krimin që i bëhet gjuhës. Jemi dëshmitarë të shkeljes së rregullave gjuhësore pothuajse në të gjitha llojet e komunikimit, përfshirë edhe librat që i botojmë, dhe më skandalozja e më e dhimbshme, tekstet shkollore që i hartojmë. Gabimet e shumta gjuhësore, janë të pranishme thuajse në të gjitha lëndët, në të gjitha tekstet shkollore, duke filluar nga librat e gjuhës shqipe edhe tek të gjithë librat tjerë.

Shërbimi, gjuhës amtare duhet t'i bëhet nga secili prej nesh dhe deri te institucionet shtetërore dhe tek ato private, të cilat e kanë edhe obligim kushtetues. Në shumë vende të botës gjuha amtare mbrohet me ligj.

Një element bazë për shmangien e gabimeve drejtshkrimore është ngritja e ndërgjegjes dhe kulturës gjuhësore të secilit prej nesh, duhet të gjithë të mundohemi të shkruajmë pa gabime. Çdo individ e ka për detyrë të bëjë çmos për mbrojtjen dhe zbatimin e drejtë të normave dhe rregullave gjuhësore.

Nga ana tjetër kur gjuhët shuhen, diversiteti kulturor, i cili përbën pasurinë e njerëzimit, gjithashtu zbehet.

Më shumë se 43% e rreth 6700 gjuhëve të folura në botë kërcënohen me zhdukje. Kjo do të thotë se çdo dy javë, një gjuhë zhduket përgjithmonë, duke marrë me vete një trashëgimi të tërë kulturore dhe intelektuale. Çdo gjuhë dhe dialekt që ekziston në botë u lejon atyre që i flasin të përcaktojnë veten si një komunitet, me një sërë referencash kulturore, një histori dhe shpesh vlera të përbashkëta.

Për herë të parë që nga përfundimi i Luftës së Ftohtë, kërcënimi i luftës bërthamore globale nuk është dukur kurrë kaq real. Sa real është saktësisht ky rrezik? Është e pamundur të dihet. Kokat bërthamore grumbullohen nga shtete të caktuara si një 'parandalues'; me konceptin e "shkatërrimit të siguruar reciprokisht" mjaftueshëm për të ndaluar këdo që të përdorë një armë të tillë. Kjo është teoria, gjithsesi. Por cilat kombe i kanë ato në të vërtetë? Dhe, më e rëndësishmja, cila është shkalla e arsenalit bërthamor të secilit komb? Le të zbulojmë ...



Koreja e Veriut

Koreja e Veriut vlerësohet se ka 30 koka bërthamore. Janë nëntë vende në Tokë që kanë deklaruar zyrtarisht se zotërojnë armatim bërthamor. Vendi me më pak koka luftarake - fatmirësisht - është Koreja e Veriut. Ne themi 'fatmirësisht' sepse Koreja e Veriut është më e afërta që kjo listë ka me një komb mashtrues. Mendohet se kanë 30 koka luftarake, por materiali do të bëhet dyfish nëse dëshirohet...



Izraeli

Izrael vlerësohet se disponon 90 koka bërthamore. Mendohet se Izraeli është i aftë të dërgojë bomba bërthamore nga ajri, si raketa lundrimi të lëshuara nga nëndetëset dhe përmes linjës "Jericho" të raketave balistike (që kanë rreze të mesme deri në interkontinentale). Izraeli ka poseduar armë bërthamore që nga vitet 1960, por kurrë nuk e ka pranuar zyrtarisht ekzistencën e programit të tij bërthamor, duke iu përmbajtur një politike të fshehtësisë bërthamore. Si e tillë, shkalla e vërtetë e programit të saj bërthamor është kryesisht e panjohur...



India

India vlerësohet të ketë 165 koka bërthamore. Me stokun e tyre të armatimit bërthamor në më të madhin ndonjëherë, programet e Indisë nuk janë krijuar për t'i ndihmuar ata të luftojnë kombet nga ana tjetër e botës, si shumë vende të tjera në këtë listë. Ata kanë grumbulluar armë bërthamore si një mjet për të mbrojtur veten gjatë konflikteve me vendet fqinje si Pakistani dhe Kina.



Pakistani

Pakistani vlerësohet të ketë 170 koka bërthamore. Me një kapacitet të ngjashëm bërthamor si fqinji dhe rivali i tij India, Pakistani i sheh armët bërthamore si thelbësore për ruajtjen e sigurisë kombëtare, kryesisht për të kompensuar fuqinë ushtarake të Indisë. Pas luftës me Indinë, në 1971, Pakistani bëri hapa të mëdhenj drejt prodhimit të pasurimit të uranimit

Kombet me numrin më të madh të kokave bërthamore dhe i vetmi vend për të cilin thjesht nuk dimë



dhe plutoniumit për përdorim në armë. Kjo shënoi fillimin e historisë së armëve bërthamore të Pakistanit.



Mbretëria e Bashkuar

Mbretëria e Bashkuar vlerësohet të ketë 225 koka bërthamore. Është e drejtë, ol' Blighty i vogël ka numrin e pestë më të madh të kokave bërthamore nga të gjitha 195 kombet në Tokë. Edhe pse, siç thamë, vetëm nëntë janë deklaruar zyrtarisht se nuk kanë fare. Baza detare HM Clyde në Skocinë përfundimor është shtëpia e parandalimit bërthamor të Mbretërisë së Bashkuar. Ndërsa nëndetëset nga të cilat do të qëlloheshin janë të vendosura në Faslane.



Franca

Franca vlerësohet të ketë 300 koka bërthamore. Magazina e katërt më e madhe e planetit të armëve të shkatërrimit në masë është Franca. Pavarësisht se janë një komb miqësor i përfshirë në shumë pak mosmarrëveshje ose luftëra të mundshme, francezët kanë 300 koka bërthamore. Të gjitha janë dislokuar dhe gati për t'u përdorur. Franca, megjithatë, ka zvogëluar arsenalin e saj bërthamor me 50% që nga fundi i Luftës së Ftohtë.



Kina

Kina vlerësohet të ketë 500 koka bërthamore. Nuk do të jetë tronditëse për askënd që të zbulojë identitetin e tre të parëve në këtë listë. Thënë kështu, rendi i renditjes dhe numrat specifikë mund të befasonjë disa. Në vendin e tretë, me 500 koka luftarake

është Republika Popullore e Kinës. Pentagoni ka thënë se ata presin që ky numër të rritet në 1000 koka luftarake deri në vitin 2030.



SHBA

SHBA vlerësohet se ka 5000 koka bërthamore. Përpara Kinës, me një diferencë, janë Shtetet e Bashkuara. Me rreth 5,000 armë bërthamore, ato nuk janë larg nga vendi i parë këtu në këtë numërim të zymtë. Kjo mund të tingëllojë si shumë koka bërthamore, por në kulmin e saj në vitin 1967, SHBA kishte mbi 32,000 koka luftarake në arsenalin e saj të gjerë. Aktualisht ka vetëm 2,000 të dislokuar dhe në gjendje të shkarkohet në rast lufte.



Rusia

Rusia vlerësohet se ka 6000 koka bërthamore. Vendi që ka ndërtuar dhe grumbulluar numrin më të madh të armëve bërthamore është, çuditërisht, Rusia. Historikisht, Rusia ka parë gjithmonë armët bërthamore si kërcënimin e saj përfundimtar dhe ka kërkuar të mbajë një arsenal të krahasueshëm - ose superior - me atë të Shteteve të Bashkuara. Më shumë se 1,600 nga 6,000 që kanë janë dislokuar dhe gati për t'u pushuar nëse kërkohet.



Irani?

Koka bërthamore të parashikuara nga Irani: E panjohur. Ne përfundojmë përmbljedhjen tonë me një vend që ka një kapacitet të panjohur bërthamor. Irani është transparent në lidhje me të paturit e një programi bërthamor, por këmbëngul se nuk ka zhvilluar koka luftarake dhe nuk ka plane për ta bërë këtë. Kjo nuk është diçka që i ka bindur të gjitha shërbimet e ndryshme të inteligjencës në botë.

Materiali nanoteknologjik, "mrekullia" që do të ndryshojë botën, kalon testet e sigurisë njerëzore

Në një epokë ku përparimet teknologjike po transformojnë me shpejtësi jetët, shkencëtarët kanë bërë një hap të rëndësishëm në nanoteknologji, duke u fokusuar në grafen - një material i njohur për vetitë e tij të jashtëzakonshme dhe potencialin e madh në aplikime të ndryshme.

Ky nanomaterial revolucionar, i njohur si materiali më i hollë, më i fortë dhe më fleksibël deri më tani, aktualisht po zhvillohet me një sy të mprehtë për sigurinë e shëndetit të njeriut.

Premtimi i Grafenit: Agimi i një epoke të re

Hulumtimet e fundit zbulojnë se inhalimi i kontrolluar i një forme specifike të grafenit, i njohur si oksid grafeni, nuk paraqet rreziqe afatshkurtëra shëndetësore për funksionet e mushkërive ose kardiovaskulare.

Ky zbulim vjen nga prova e parë klinike e ekspozimit të kontrolluar që përfshin pjesëmarrës njerëz, duke theksuar sigurinë e materialit në kushte specifike.

Oksidi i grafenit, një formë grafeni e përputhshme me ujin, u përdor në këtë studim pionier për të siguruar pastërtinë dhe pajtueshmërinë ultra të mundshme për aplikimet e mundshme mjekësore.

Studimi, një përpjekje bashkëpunuese nga studiues nga Universitetet e Edinburgut dhe Mançesterit, nënkupton një hap kritik në të kuptuarit e ndërveprimit të grafenit me trupin e njeriut.

Pavarësisht nga rezultatet premtuese, studiuesit mbrojnë hetime të mëtejshme për të eksploruar efektet e dozave më të larta ose ekspozimit të zgjatur ndaj grafenit, duke marrë parasysh strukturën e tij tepër të mirë.

Rreziqet e mundshme të thithjes së oksidit të grafenit

Joshja e grafenit si një 'material i mrekullueshëm' buron nga zbulimi i tij në 2004 dhe potenciali i tij për të revolucionarizuar industrinë, duke filluar nga elektronika te pastrimi i ujit.

Aplikimi i tij në zhvillimin e terapive të synuara për kancerin dhe kushte të tjera shëndetësore, si dhe përdorimi i tij në pajisje dhe sensorë të implantueshëm, nënvizon nevojën për vlerësime rigorozet të sigurisë përpara përdorimit klinik.

Hulumtimi përfshiu 14 vullnetarë të cilët u ekspozuan ndaj oksidit të grafenit në kushte të kontrolluara me përpikëri.

Pjesëmarrësit morën frymë në material përmes një maske ndërsa po bënë biçikletë brenda një dhome ekspozimi të lëvizshme, duke siguruar monitorim të saktë të çdo efekti shëndetësor.

Studimi matë me përpikëri ndikimet në funksionin e mushkërive, presionin e gjakut, mpiksjet e gjakut dhe shënuesit e inflamacionit, me teste përcjellëse të kryera për të krahasuar përgjigjet ndaj madhësive të ndryshme të oksidit të grafenit dhe ajrit të pastër.

Asnjë kërcënim i menjëhershëm për shëndetin e njeriut

Çuditërisht, studimi nuk gjeti efekte negative të rëndësishme në funksionin e mushkërive ose presionin e gjakut, me vetëm një sugjerim minimal të ndikimit në koagulimin e gjakut - një zbulim që nënvizon nevojën për dizajn të kujdesshëm të materialit në aplikimet e nanoteknologjisë.

Dr. Mark Miller, nga Universiteti i Edinburgut, theksoi rëndësinë e sigurimit të prodhimit të sigurt të nanomaterialeve si grafeni për të shfrytëzuar potencialin e tyre të plotë në mënyrë të sigurt.

"Nanomaterialet si grafeni premtojnë kaq shumë, por ne duhet të sigurohemi që ato të prodhohen në një mënyrë që të jetë e sigurt përpara se të mund të përdoren më gjerësisht në jetën tonë", - shpjegoi dr. Miller.


"Të jesh në gjendje të eksplorosh sigurinë e këtij materiali unik te vullnetarët njerëzorë është një hap i madh përpara në të kuptuarit tonë se si grafeni mund të ndikojë në trup. Me një dizajn të kujdesshëm, ne mund të shfrytëzojmë në mënyrë të sigurt maksimumin nga nanoteknologjia".

E ardhmja e nanomaterialeve të sigurta në mjekësi

Në mënyrë të ngjashme, profesori Kostas Kostarelos i Universitetit të Mançesterit dhe i Institutit Katalan të Nanoshkencës dhe Nanoteknologjisë (ICN2) në Barcelonë theksoi udhëtimin dhjetëvjeçar drejt këtij momenti historik kërkimor.

Ai reflektoi mbi qasjen gjithëpërfshirëse që kombinon shkencën e materialeve, biologjinë dhe ekspertizën klinike.

"Ky është studimi i parë i kontrolluar ndonjëherë, që përfshin njerëz të shëndetshëm për të demonstruar se format shumë të pastra të oksidit



të grafenit, me një shpërndarje të madhësisë specifike dhe karakter sipërfaqësor, mund të zhvillohen më tej në një mënyrë që do të minimizonte rrezikun për shëndetin e njeriut", - tha Kostarelos.

"Na janë dashur më shumë se 10 vjet për të zhvilluar njohuritë për të kryer këtë kërkim, nga pikëpamja materiale dhe shkenca biologjike, por edhe nga kapaciteti klinik për të kryer studime të tilla të kontrolluara në mënyrë të sigurt, duke mbledhur disa nga

ekspertët kryesorë në botë, të kësaj fushe".

Profesori i Fondacionit Britanik të Zemrës, Bryan Williams, vlerësoi implikimet e studimit për zhvillimin e pajisjeve dhe trajtimeve të reja mjekësore, duke shprehur pritshmërinë për studime të ardhshme që mund të hapin rrugën për përdorimin e sigurt të nanomaterialeve në aplikimet për shpëtimin e jetës.

"Zbulimi se ky lloj grafeni mund të zhvillohet në mënyrë të

sigurt, me efekte anësore minimale afatshkurtra, mund të hapë derën për zhvillimin e pajisjeve të reja, inovacioneve të trajtimit dhe teknikave të monitorimit", - tha Williams.

"Ne mezi presim të shohim studime më të mëdha gjatë një periudhe më të gjatë kohore për të kuptuar më mirë se si mund të përdorim në mënyrë të sigurt nanomaterialet si grafeni për të bërë hapa të mëdhenj në shpërndarjen e barnave që shpëtojnë jetën të pacientët".

Potenciali i grafenit është më në fund në kohën më të mirë

Si përmbledhje, ky studim emocionues dhe i vonuar prej kohësh mbi grafenin, veçanërisht formën e tij

oksidore, shënon një moment historik të rëndësishëm në udhëtimin drejt shfrytëzimit të potencialit të plotë të nanoteknologjisë, duke i dhënë përparësi shëndetit të njeriut.

Studiuesit kanë demonstruar se ekspozimi i kontrolluar ndaj oksidit të grafenit nuk përbën kërcënim të menjëhershëm për shëndetin e mushkërive apo atë kardiovaskular, duke hedhur një themel për inovacionet e ardhshme në fusha të ndryshme, nga mjekësia te teknologjitë mjedisore.

Ky kërkim siguron publikun dhe komunitetin shkencor për sigurinë e nanomaterialeve në zhvillim dhe inkurajon eksplorimin dhe zhvillimin e vazhdueshëm, duke siguruar që premtimi i jashtëzakonshëm i grafenit mund të realizohet në mënyrë të sigurt dhe efektive.

Ndërsa ne futemi më tej në fushën e nanoteknologjisë, ky studim shërben si një kujtesë kryesore e rëndësisë së kërkimit të përpiktë dhe aplikimit të përgjegjshëm në zhblokimin e fuqisë transformuese të materialeve si grafeni.



Gjergj Klimi, pedagogu skënderbegas i 'balistikës së predhave'

Gjergj Klimi studiuesi që identifikohet me “gjetjen mbi balistikën e predhave që përdoren në ushtri”. Kështu e vlerësonte profesor Gjergj Klimin një studiues i Pentagonit, tekta shprehte konsideratat e tij për librin më të fundit “Elements of Exterior and terminal Ballistics”. I gjashti në kolanën e botimeve të këtij lloji me autorësinë e tij, libri i profesorit shqiptar që ushtronte pedagogun në universitetet e Nju Jorkut, tërhiqte vëmendjen, ndër të tjera, për mënyrën interesante të shfrytëzimit të ligjit të Njutonit dhe atij të Snellit në çështjet e balistikës, por jo vetëm. Po kush është profesor Klimi që ka bërë emër në qarqet shkencore të Amerikës për botimet në këtë fushë pak të studiuar e hulumtuar dhe çfarë veprimtarie shkencore ka kryer në vite, si një kërkues e pedagog modest, i thjeshtë e i përkushtuar. Çfarë përfaqëson puna e tij shkencore dhe për se e vlerësojnë specialistët e fushës.

Ka qenë viti 1972, kur profesori i njohur Gjergj Klimi, i ri në moshë atëherë, kapërceu postbllokun e Akademisë Ushtarake, garnizonit më të madh në qytetin e Tiranës, për të ushtruar profesionin e pedagogut të matematikës e fizikës. Dashuria për profesionin dhe aftësia për të depërtuar në zemrat e kadetëve me uniformë me çiltërsi dhe kulturë, i dhanë dorë për ta kryer me sukses detyrën. Plot 20 vite shërbeu aty, me përkushtim e pasion.

Familja

Gjergj Klimi, biri i Vlashit dhe Violetës lindi në Tiranë në vitin 1947. Pas përfundimit të shkollës shtatë vjeçare “10 Korriku”, kreu gjimnazin “Sami Frashëri” në Tiranë, për të vijuar studimet universitare në Fakultetin e Shkencave, në degën Matematikë-Fizikë. Familja e tij me origjinë nga Voskopoja, u vendos në Tiranë, falë këmbënguljes së gjyshit, që la vendlindjen dhe bleu një shtëpi prej qerpiçi, me disa toka përreth në qendër të qytetit (aty ku ka qenë MAPO e madhe, më vonë disko “Albania”), në rrugën e Dibrës, të cilën e bëri dykatëshe me shumë dhoma e anekse. Nëna e tij, Violeta nga Pogradeci, vinte në Tiranë nga një familje e pasur dhe me tradita



të hershme. Familja e saj kishte një shtëpi dykatëshe me bahçe me një vresht me rrush e pemishte frutash dhe kishin ndërtuar një hotel dykatësh me restorant në katin e parë e dhoma gjumi në katin e dytë, pranë tij kishte edhe një pajisje furnizimi me karburant. Gjendej në rrugën kryesore, përballë liqenit të Ohrit. Violeta kishte edhe dy vëllezër, Kristaqin e Mihallaqin dhe dy motra Gliqirien e Adelinën. Bashkëshortja e Klimi, Dorina Paço, me të cilën ka dy djem, Iveni dhe Hiperioni, është e bija e skulptorit të shquar Janaq Paço. Ajo ka përfunduar studimet për frëngjisht dhe ka punuar shumë vite në Shtëpinë Botuese “Naim Frashëri”, Tiranë.

Karriera

Profesor Gjergj Klimi e ka nisur profesionin si mësues matematike e fizike në vitin 1970 fillimisht në shkollën e Arbanës në Tiranë e pastaj në gjimnazin e Laçit. Nga viti 1972 dhe deri në vitin 1992 ka ushtruar profesionin e pedagogut në Akademinë ushtarake nga pedagog i thjeshtë te përgjegjës i departamentit të Fizikës. Karrierën profesionale si mësime të ndryshme të llogaritjes, probabilitetit dhe statistikës.



vonë në Kolegjin e Teknologjisë NYC dhe në Universitetin Pace (Nju Jork). Në vitet '90, ka punuar në Komitetin e Shkencës dhe Teknologjisë dhe në Ministrinë e Arsimit të Lartë dhe Kërkimit shkencor në Shqipëri si Drejtor i Zyrës “Tempus”, përgjegjës për zbatimin e Programeve të Komunitetit Evropian për rristurimin e arsimit të lartë. Është vlerësuar me Medaljen e Artë të Shqiponjës, nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë, për kontributin e dhënë në lëvizjen demokratike kundër diktaturës dhe për rristurimin e arsimit të lartë në Shqipëri.

Botimet

Gjergj Klimi, tashmë profesor në pension, për vite me radhë ka qenë pedagog i Matematikës në “NYC College of Technology” dhe në “Pace University” (New York). Është autor i pesë librave për balistikën e jashtme: “Balistika e Jashtme me Zbatime” (2008), “Balistika e Jashtme e Armëve të Vogla” (2009), “Balistika e Jashtme: Një Qasje e Re” (2010), “Balistika e Jashtme: Metodot e Shquara,” (2014) “Elementet e Balistikës së Jashtme: Qitje me distancë të largët” (2016). “Ballistika e Jashtme me Aplikime 2011”.

Botimet e Klimi janë ndjekur me shumë interes nga autoritetet e fushës në SHBA. Edukimi universitar: Ph.D 1999 Universiteti Tiranës, Fakulteti Shkencave të Natyrës, Tiranë, me tezën: “Studime mbi aplikimin e Dinamikës së Gazeve dhe Fizikës bërthamore për vlerësimin e efekteve imobilizuese të municioneve konvencionale dhe bërthamore”. 1969 Universiteti Tiranës, Fakulteti Shkencave të Natyrës, Tiranë, Diplomë në Fizikë. Provime Pasuniversitare: Universiteti Tiranës: Gjuha Angleze (1978); Dinamika e Gazeve (1990); Mekanika (1996). Trajnime afatshkurtër: Universiteti i Ferrarës, Itali 1994; Instituti për Studime të Kërkimit Shkencor dhe Dokumentimit, Romë, Itali 1994.

Punësimet: Shtator 2005-2015, “NYC College of Technology” (CUNY), Departamenti i Matematikës, Mësimdhënie në Matematikën Bazë, Statistikën Elementare, Përllogaritje dhe nivele të ndryshme të llogaritjes, probabilitetit dhe statistikës.

Shtator 2009-2011, 2013-2015 zëvendësues dhe me kohë të plotë. Shtator 2000-2015, Pace University, Departamenti i Matematikës (Kampusi Manhattan), ndihmës ass/profesor në Matematikë. Mësimdhënie në Matematikën Bazë, Matematikë

fundore Përllogaritje dhe nivele të ndryshme të llogaritjes, Probabilitetit dhe Statistikës. Shtator 2004 - gusht 2005 Mesivta Yesodey Yeshurun NY, Mësimdhënie Përllogaritje AP, Para-llogaritje, Matematik Bazë, Matematikë AB, IT. Tetor 2001 - gusht 2004, Pace University, Center for Academic Excellence (Kampusi Manhattan) Specialist/Kordinator Laboratori Matematike (pozicion me kohë të plotë) Mësimdhënie & eksperiencia të tjera profesionale: 1995 – 1997 Ministria e Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor. Tiranë, Shqipëri: Drejtor i Zyrës së Tempusit të Shqipërisë 1993 – 1995 Komiteti Shkencës dhe Teknologjisë, Tiranë. Zyrtar i Lartë në Drejtorinë e Politikave të Shkencës dhe Programeve Kombëtare. 1988 – 1993 Akademia Ushtarake “Skënderbej”, Tirana. Përgjegjës i Departamentit të Fizikës. Mësimdhënie në Lëndën e Fizikës së Përgjithshme, Përllogaritje; Probabilitet. 1972 -1992 Akademia Ushtarake “Skënderbej”, Tirana. Departamenti i Matematikës dhe Fizikës.. Mësimdhënie në Përllogaritje; Probabilitet. 1988 – 1992 Akademia Ushtarake e Shtabit të Përgjithshëm (Institut Post Graduate) Tirana. Mësimdhënie në “Aplikim i elementeve të fizikës së shpërthimeve”. 1970 -1972 Shkolla e Gjymnazit – Laç. Mësues në lëndën e Fizikës 1972 Mësues në shkollën e Arbanës, Matematikë e Fizikë.

Publikimet më të rëndësishme: Libra: Klimi G. “Elements of Exterior and Terminal Ballistics”, Xlibris, shkurt 2021; “Elements of Exterior Ballistics: Long Range Shooting”, Xlibris, mars 2016; “Exterior Ballistics: The Remarkable Methods”, Xlibris, shkurt 2014; “Exterior Ballistics: A New Approach”, Xlibris, prill 2010; “Exterior Ballistics of Small Arms: Companion to Exterior Ballistics with Applications”, Xlibris, 2009; “Exterior Ballistics with Applications: Skydiving, Parachute Fall, Flying Fragments”, Xlibris, 2008; Botim i tretë publikuar në 2011. Kërkime shkencore, leksione: “Studime mbi aplikimin e gazdinamikës dhe fizikës bërthamore për vlerësimin e efekteve imobilizuese të municioneve konvencionale dhe bërthamore”, 1999. Disertacion i prezantuar për gradën Ph.D., Libraria Kombëtare; “Prezantim i studimit mbi bombën me neutron”, Akademia Ushtarake e Shtabit të Përgjithshëm. 1989, Leksione të Fizikës – Akademia Ushtarake e Tiranës, 1991; “Elemente të Fizikës së aplikuar në ushtri”, 1986, Akademia Ushtarake. “Leksione mbi fizikën e shpërthimit”, 1988, Akademia Ushtarake; Shtabi i Përgjithshëm, Tiranë, 1983, “Elementet e probabilitetit të aplikuar”, 1983, Libër, Botim i Ministrisë së Mbrojtjes së Shqipërisë; “Studime mbi aplikimin e gazdinamikës dhe fizikës bërthamore për vlerësimin e efekteve të paafetësishë të municioneve konvencionale dhe bërthamore”, 1999 – Disertacion i prezantuar për gradën PhD (Biblioteka Kombëtare, Tiranë). Prezantime & Studime: Klimi, G. Boatwright, J. “Metodat e reja bashkëkohore në balistikën e jashtme”. “City Tech Faculty Research Conference”, mars 30, 2012 Klimi, G. Greenstein J. “Vlerësimi i fuqisë shkatërruese të meteorit Baringer Tungusta, “City Tech Faculty Research Conference”, 1 prill 2012. “Trajektorja e predhës – Modeli i Drejtësisë dhe ligji Snell-it”, “City Tech Faculty Research Conference”, 12 mars 2010.

Prezantim mbi librat e Klimi, G: “Exterior Ballistics with Applications” dhe “Exterior Ballistics of Small Arms” në Akademinë Ushtarake Mbretërore, Departamenti i Sistemeve të Armëve dhe Balistikës (ABAL), Bruksel, Belgjikë, 10 prill 2009 Klimi, G., Lowenthal J. “Zgjidhja e ekuacioneve diferenciale të lëvizjes së predhës, duke përdorur metodën e Euler-it”, prezantim me poster, Takimi Vjetor i Seksionit Metropolitan New York, 3 maj 2008, Mascuili A. “Zgjidhja analitike e ekuacioneve diferenciale të lëvizjes së predhës, duke përdorur metodën Siaçi”, “City Tech” sesioni 5-të vjetor i posterave kërkimore shkencore të Fakultetit dhe Studentëve, 15 nëntor 2007, Prezantim Posterit “Energjia e tërmeteve dhe testeve bërthamore nëntokësore”, Universiteti William Paterson, “5th Garden State Undergraduate Mathematics Conference”, 12 prill 2008; SENCER Project i Grantit: Problemet e botës reale. Implementimi në “City Tech”, Viti Akademik 2010 – 2011.

Risia e aplikimit në ligjit e Njutonit “Formalisht ngjan me ligjin e Snellit i interpretuar sipas Njutonit. Përjasja te ky ligj që autori i ka vënë emrin “snel-low” në analogji është komplet origjinal si nga trajtimi dhe rezultati që merret në balistikën e jashtme. Autori e ka quajtur “snel low”, por nuk janë e njëjta gjë. Janë të ngjashëm në formë por jo në trajtim. Autori shkon më tej duke na prezantuar “tangent low”, i cili është interpretim i saktë i përdorimit të balistikës së jashtme me trajtim origjinal e pa përdorimin e sistemit të ekuacioneve diferenciale. Në literaturën botërore nuk përdoret ligji i “snel low”, aq më pak në balistikën e jashtme. Lexuesi i vëmendshëm e vë re se trajtimi i bërë nga Gjergji në faqen 148 si edhe në dy librat e mëparshëm të tij nuk ka lidhje me “Njuton snel low”, të cilin autori e ka përdorur me modesti vetëm për një farë ngjashmërie që formalisht ata kanë.



Prof. Asoc. Dr. BERNARD ZOTAJ

Katër djem në Tiranë masakrohen...

(Në kuadrin e 80-vjetorit të rënies)

U njohën ata në vitet e zjarrrta

Në një rrugë të Tiranës, që mban emrin “4 Dëshmorët” ngrihet një lapidar. Është një ndër simbolet që përjetësojnë kujtimin e të rënëve, kujtimin e dëshmorëve të Atdheut. Ata ishin katër, Gjergj Frashëri, Skënder Kosturi, Trajan Pekmezi e Viktor Gjokoreci. Katër nga të armatës së madhe të luftës, katër nga tërë ajo rini antifashiste që ngritën grushtin lart e morën armët për të sjellë lirinë, qëllimi më i lartë i të cilëve ishte lufta për çlirim e vendit. Dhe ky ishte një ideal që ushqej nga dashuria për Atdheun. Të katër u njohën në vitet e zjarrrta, ku shkelën dhe vrapuan në të njëjtën rrugë herë në rolin e atentatorit, herë në rolin e shpërndarësit të traktateve, herë të kthyer nga malet me partizanët. Edhe në ditët më të vështira, në ditët e punës ilegale në kryeqytet punuan krah njeri-tjetrit.

Gjergj Frashëri u lind në vitin 1924 dhe ishte bir i një familjeje me tradita patriotike. Më 1936 u regjistrua në klasën e parë të gjimnazit të shtetit në Tiranë. Në qershor të vitit 1942, mbasi morën fund mësimet shkollore, hyri si ndihmës-mekanik në një garazh të Tiranës. Më 1943 Gjergji u bë anëtar i njësitit gueril të Tiranës. Si pjesëtar i njësitit mori pjesë në disa aksione të armatosura që u kryen në kryeqytet. Në këto aksione ai u tregua si përherë i shkathët dhe trim. Më 30 tetor 1943, ai kaloi në rreshtat partizane, në fillim në batalionin “Dajti”, që vepronte në afërsitë e Tiranës, dhe më vonë në BrIIS. Si partizan, Gjergji mori pjesë në luftimet që u zhvilluan në Qafën e Kërrabës, të Çermenikës, të Labinotit, të Martaneshit, të Polisit dhe të Kostenjës. Në fillim të janarit 1944, u sëmur, u kthye me lejen e shtabit të brigadës në Tiranë, ku qëndroi ilegal. Përsëri u aktivizua me njësitin gueril dhe vazhdoi veprimtarinë...

Skënder Kosturi lindi në vitin 1922 në një shtëpi të Tiranës, pranë ish-stacionit të trenit. Në Gjimnazin e Tiranës, Skënderi u dallua për ndjenja të thella patriotike. Vërejtjet që kishte marrë nga drejtorja e shkollës dëshmojnë për aktivitetin e tij revolucionar. Njohja me Qemal Stafën ndikoi shumë në formimin dhe në aktivitetin e tij të mëvonshëm antifashist. Ai u aktivizua me Grupin Komunist të Shkodrës. Disa muaj pas krijimit të PKSH-së, në mars të vitit 1942, pranohet anëtar i PKSH-së. Qarkori i Partisë për Tiranën e caktoi me detyra partie në Prizren, në Shkodër dhe në Vlorë, ku u plagos, arrestohet, por mundi të arratiset dhe të kthehej në Tiranë.

Viktor Sterjo Gjokoreci lindi në Korçë, më 4 dhjetor 1928. Babai që ishte komunist e brumosi me ide revolucionare, me guxim për pjesëmarrje në demonstrata e aktivitete të tjera revolucionare. Në vitin 1942 u bë anëtar i grupeve ilegale të Rinisë Komuniste. Në vitin 1943 ai u bë anëtar i njësiteve guerile të Tiranës, të cilat në atë kohë kryenin shumë aksione. Nga fundi i vitit 1943, ai doli partizan në njësitet që vepronin në rrethet e Tiranës, por papritur e zuri bronshiti dhe e detyroi të kthehej në qytet. Njësitit gueril u ngarkon një detyrë e rëndësishme, për të vlarë një agjent të Gestapos gjermane. Plumbat e armëve të Viktorit dhe të Gjergj Frashërit e rrëzuan për tokë spiunin e urryer nga të gjithë. Atentati u krye me sukses, por të dy shokët u ndeshën me një grup xhandarësh, në përleshje me ta Gjergji u plagos. Viktori, ndihmoi shokun e plagosur dhe kështu ata mundën të iknin dhe të strehoheshin në një shtëpi që ishte bazë e Lëvizjes. Pas shumë kërkimesh, natën vonë spiunët ranë në gjurmë dhe i arrestuan, i torturuan dhe i pushkatuan.

Trajan Stavri Pekmezi lindi në Ohër në vitin 1911. U brumos në një familje atdhetare. Ndoqi shkollat e kohës dhe u formua si një antifashist, duke marrë pjesë në mjaft veprimtari në interes të lëvizjes. Pas mbarimit të shkollës së mesme, Trajani ushtroi zanatin e mekanik-hidraulikut, ku dyqanin e tij e ktheu në çerdhe të mbledhjeve e konferencave ilegale. Ishte një ideal që ushqej nga dashuria për Atdheun. Për këtë ideal, i sëmuri

Ata ishin katër...



Gjergj Frashëri



Skënder Kosturi



Trajan Pekmezi



Viktor Gjokoreci



“ GJERGJ FRASHËRI, SKËNDER KOSTURI, TRAJAN PEKMEZI E VIKTOR GJOKORECI. KATËR NGA TË ARMATËS SË MADHE TË LUFTËS, KATËR NGA TËRË AJO RINI ANTIFASHISTE QË NGRITËN GRUSHTIN LART E MORËN ARMËT PËR TË SJELLË LIRINË, QËLLIMI MË I LARTË I TË CILËVE ISHTE LUFTA PËR ÇLIRIM E VENDIT. DHE KY ISHTE NJË IDEAL QË USHQEHEJ NGA DASHURIA PËR ATDHEUN. TË KATËR U NJOHËN NË VITET E ZJARRTA, KU SHKELËN DHE VRAPUAN NË TË NJËJTËN RRUGË HERË NË ROLIN E ATENTATORIT, HERË NË ROLIN E SHPËRNDARËSIT TË TRAKTATEVE, HERË TË KTHYER NGA MALET ME PARTIZANËT. EDHE NË DITËT MË TË VËSHTIRA, NË DITËT E PUNËS ILEGALE NË KRYEQYTET PUNUAN KRAH NJERI-TJETRIT.

kontributin e tij në fitore.

Ata ishin katër të rinj antifashistë

Forcat e okupacionit dhe tradhtarët e vendit menduan se i kishin larë hesapet me popullin që kishte ngritur krye. Mendonin se e kishin frenuar lëvizjen antifashiste, e cila po shtoej nga dita në ditë. Forcat naziste dhe tradhtarët nuk menduan se ky popull kishte një parti komuniste që e udhëhiqte, kishte lëvizjeje të fuqishme që godiste armiqtë dhe tradhtarët e popullit, duke u dhënë dënimin që meritonin. I riu Gjergj Frashëri anëtar i njësitit gueril kishte marrë urdhër të kryente një atentat kundër një agentit nazist. Për ditë me radhë Gjergji studioi lëvizjet dhe takimet e spiunit dhe, më 27 shkurt 1944, nga mesdita në kafenenë e rrugës së Kusit kreu atentatin kundër tradhtarit. Shoqëruesit e tij dhe ballistët nisën të shtinin dhe një plumb e zë Gjergjin në anën e majtë, kurse një tjetër në krah, por përsëri vrapoi drejt shtëpisë së Trajanit, e cila ishte dhe bazë ilegale për mjekime.


Forcat balliste bashkë me forcat gjermane e ndoqën antifashistin e plagosur pas pikave të kuqe të gjakut dhe rrethuan shtëpinë bazë. Ballistë e gjermanë hynë brenda dhe arrestuan gjithë sa ndodheshin aty: Gjergjin, Viktorin, Trajanin e sëmurë dhe prindërit e Gjergjit që kishin ardhur të takonin të birin. Gjatë

bastisjeve përreth shtëpisë tradhtarët arrestuan dhe Skënderin. Në bodrumet e zyrave të policisë u torturuan katër shokët. Nënë Dhoksisë i dukej sikur i buçisnin në vesh fjalët e Gjergjit të saj: “Mbaju e fortë nënë, ne do të jemi me shokët!”. Ata ishin së bashku dhe ashtu të katër u vranë. Gjyqi i burgut nga kryetar Xhelal Staravecka dhe mercenarë të tjerë natën vonë pasi i masakruan, i çuan në rrugën e Kusit, katër të rinjtë antifashistë.

Në mëngjes ushtarë nazistë e ballistë qëndronin për të ruajtur trupat e katër të vlarëve që i kishin lënë në rrugë për të mbjellë panik në popull dhe për ta gjunjëzuar që të hiqte dorë nga lufta për liri. Por populli shqiptar i kishte matur mirë forcat dhe ëndrrat e tij se kishte partizanët që luftonin për liri. 28 shkurti i vitit 1944 u shënua në kronikat e epopesë së Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare me emrin: “Dita e rënies së 4 dëshmorëve”.

Të katër të rinjtë janë shpallur dëshmorë: Gjergj Frashëri me vendim nr. 104, datë 20.06.1977 të ish-Komitetit Ekzekutiv të Tiranës; Skënder Kosturi me vendim nr. 104, datë 20.06.1977 të ish-Komitetit Ekzekutiv të Tiranës; Trajan Pekmezi me vendim nr. 102, datë 28.05.1978 të ish-Komitetit Ekzekutiv të Pogradecit dhe Viktor Gjokoreci me vendim nr. 102, datë 14.11.1969 të ish-Komitetit Ekzekutiv të Korçës.

Ata bashkë janë përjetësuar në emrin e një rruge, të shkollës



Vazhdojnë regjistrimet e kandidatëve për ushtarë/detarë aktivë në FA, për periudhën 07 shkurt – 12 prill 2024.

Kuota: 390 kandidatë.

Afati për dorëzimin e dokumentacionit është deri më **12 prill 2024**.

<https://www.mod.gov.al/rekrutim/>